

MANUAL TRAJNIMI

TË DREJTAT E PERSONAVE LGBTI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE MIQËSORE

PUBLIKIMI I DYTË

Tiranë, Shtator 2015



"Ky material është publikuar me mbështetjen e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij publikimi janë përgjegjësi e Ambasadës PINK / LGBT Pro dhe partnerëve të saj dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian".

FALENDERIME

Ambasada PINK falenderon Bashkitë e qyteteve Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Shkodër për mbështetjen në luftën kundër diskriminimit dhe në krijimin e hapësirave për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të administratës dhe grupeve multidisiplinare që ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve LGBTI. Shpresojmë që ky manual të shërbejë në rritjen e barazisë mes qytetarëve pavarësisht orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor.

Ambasada PINK falenderon Bashkimin Europian për mbështetjen në zbatimin e iniciativës “Përmirësimi i jetës së personave LGBT në nivel lokal” në kuadër të të cilit prodhohet edhe ky manual.

© Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri

Tiranë, Shqipëri, Shkurt 2015

Shënim mbi copyright:

Ky manual është përgatitur nga Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri me mbështetjen e Bashkimit Europian në kuadër të iniciativës “Përmirësimi i jetës së personave LGBT në nivel lokal”.

Të gjitha të dhënat e këtij materiali mund të publikohen dhe riprodhohen për aq kohë sa citohet ky manual apo burime të tjera të gjetura në të. Ky manual nuk mund të publikohet apo shpërndahet për qëllime përfitimi. Ri-publikimi i tij mund të bëhet vetëm me autorizimin e Ambasadës PINK.

Përgatiti:
Amarildo Fecanji

Asistoi:
Blerina Metaj

Design:
Artan Karoli

PËRMBAJTJA

1.

Hyrje

Objektivat e Trajnimit

2. Manuali “Të drejtat LGBT dhe ofrimi i shërbimeve jo-diskriminuese”

MODULI I PARË: TË DREJTAT LGBTI

Pjesa 1: Konceptet LGBTI

- LGBTQI2PAA
- Orientim seksual
- Identitet Gjinor
- Shkalla “Kinsey”
- Purple-Red Sexuality Scale
- Personi “Genderbread”
- Heteronormativiteti
- Heteroseksizmi dhe homofobia
- Interseksionaliteti
- Mite dhe Fakte

Pjesa 2: SITUATA LIGJORE E KOMUNITETIT LGBTI

Legjislacioni ndërkombëtar

- Aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe OKB
- Deklarata e Montrealit
- Principet e Jogakartës
- Rekomandimet 2010 (5) i KiE
- Deklarata IDAHOT
- Të drejtat LGBT në Bashkimin Evropian dhe vendet kandidate

Legjislacioni Kombëtar

- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Kodi i Punës
- Kodi Penal
- Kodi i Familjes
- Njohja Ligjore e Gjinisë

Institucionet në mbrojtje të komunitetit LGBTI

- Avokati i Popullit
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- Policia e Shtetit

- Organizatat LGBTI në vend
- Kërkesat dhe nevojat e komunitetit LGBTI
- Prioritetet e PINK 2014-2017
- Statistika dhe Perceptime
- Shkelje të të Drejtave të Njeriut
- Krimet dhe Fjalimet e Urrejtjes
- Aktivitete avokuese dhe lobuese të organizatës
- Pride dhe Manifestime të tjera

3. MODULI I DYTË SHËRBIMET MIQËSORE NDAJ KOMUNITETIT LGBTI

Pjesa 1: IDENTIFIKIMI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA

- Raste Studimore (2)

Pjesa 2: PREZANTIM SHËRBIMET MIQËSORE NDAJ LGBTI

- Gjuha
- Politikat
- Stafi
- Përfshirja
- Informacioni dhe Vizibiliteti

4. Axxhenda e Trajnimit

5. Formulari i Vlerësimit



OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

Ky manual dhe trajnimet që mund të zhvillohen përmes tij synojnë që të fuqizojnë dhe rrisin kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale dhe atyre të punësimit në lidhje me personat lesbike, gej, biseksualë, transgjinorë dhe intersex (LGBTI). Për arsye të diskriminimit historik, për shumë vite, personat e këtij komuniteti kanë qenë “të padukshëm” në sytë e institucioneve publike. Ende nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e personave LGBT të papunë, që kërkojnë strehim, etj.

Por, ndërkohë, me demokratizimin e shoqërisë, përmirësimin e legjislacionit anti-diskriminim, krijimin e praktikave dhe politikave mbështetëse dhe fuqizuese ndaj këtij komuniteti dhe rritjen e vizibilitetit të personave LGBT rritja e kapaciteteve të punonjësve të institucioneve publike është kthyer në një domosdoshmëri dhe nevojë praktike.

Objektivat e këtij manuali ndërlidhen edhe me ato të parashtruara në Dokumentin e Politikave për Përfshirjen Sociale të Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë (MMSR), siç janë zhvillimi i politikave të njëtrajtshme në bashkëpunim me Ministrinë dhe institucionet e tjera publike, monitorimi dhe vlerësimi i këtyre politikave si dhe alokimi i burimeve dhe shpenzimeve për grupet vulnerabël të prekur nga strategjia në fjalë. Edhe pse nuk ka vendosur një objektiv specifik në shifra, për shkak të mungesës së të dhënave për personat LGBT, kjo strategji synon të rrisë aksesin e tyre në politikën aktive të tregut të punës (PATP), të rrisë shkallën e punësimit të komunitetit, të rrisë përqindjen e personave LGBT të mbuluar me sigurim shëndetësor dhe të rrisë me 20% strehimin social të shpërndarë për personat LGBT.

Këto objektiva, të cilat përputhen edhe me disa nga kërkesat kryesore të komunitetit LGBTI, e bëjnë shumë të domosdoshëm zhvillimin e trajnimeve informuese për zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat e Shërbimit Kombëtar Social me qëllim rritjen e njohurive për këtë komunitet si dhe disa nga nevojat, sfidat dhe problemet e tyre kyçe në lidhje me punësimin, strehimin dhe ofrimin e të mirave të tjera.

Manuali i trajnimit synon të fuqizojë njohuritë për tematikën LGBT dhe të zgjerojë fushën e veprimit dhe mbështetjes nga shërbimet e mësipërme që targetojnë edhe komunitetin LGBT. Ai është i përdorshëm edhe për trajnime me grupe dhe punonjës të institucioneve të tjera të cilat ndërveprojnë me qytetarët.



MODULI I PARË:

TË DREJTAT LGBTI

- LGBTQQI2PAA

Shpesh ka debate për mënyrën se si komuniteti LGBTI duhet të vet-quhet. Ndërkohë që në zhargonin e përditshëm dhe atë tradicional ka shumë terma, të pranuar ose jo, lëvizja ndër vite ka evoluar edhe në kuptimin e vet-emërimit. Fillimisht është përdorur vetëm termi “gej” i cili, për fat të keq, ka lenë jashtë shumë grupe dhe njerëz të komunitetit që nuk vet-identifikohen si persona që tërhiqen nga njerëz të të njëjtit seks. Ndërkohë termi “gej” është i përdorshëm vetëm për gjininë mashkullore, çka lë jashtë femrat dhe personat që nuk identifikohen me asnjë gjini.

Kundërshtarët e komunitetit LGBT përdorin shpesh zhargonin personat homoseksualë i cili është neutral në aspektin gjinor por që përjashton shumë njerëz të komunitetit, si për shembull biseksualët etj. Gjithashtu përdoret edhe termi minoritetet seksuale i cili është më akademik por që vë theksin tek aspekti seksual dhe përjashton aspektin kulturor e politik, që është një nga arsyet përse filloi të përdorej termi gej.

Personat e komunitetit LGBTI nuk duan të përkufizohen thjesht në aspektin e sjelljes por si qenie njerëzore, të plota dhe komplekse. Në shumë vende tradicionale, siç mund të jetë edhe Shqipëria termat “homoseksual” apo “minoritet seksual” mund të bëhen shkak për stigmatizim të komunitetit LGBT për shkak të fjalës “seks/ual”. Me kalimin e viteve përkrah termit gej, u shtuan edhe të tjerat si lesbike, biseksual dhe trans-gjinor. Ndërkohë shumë gërma të tjera nuk njihen ende nga publiku i gjerë. Më poshtë është lista e gjatë e termave:

- Lesbike: një femër e cila përjeton tërheqje fizike, emocionale dhe romantike ndaj një femre tjetër;
- Gej: një mashkull i cili përjeton tërheqje fizike, emocionale dhe romantike ndaj një mashkulli tjetër;
- Biseksual/e: një person që përjeton tërheqje fizike, emocionale dhe romantike ndaj një mashkulli apo femre tjetër;
- Trans: një person, identiteti gjinor i të cilit/cilës nuk korrespondon me seksin e dhënë në lindje.
- Queer: është një term ombrellë i cili përdoret për minoritetet seksuale dhe gjinore të cilët nuk identifikohen si heteroseksualë apo si persona të lindur në gjininë e tyre. Ndërkohë shumë persona queer nuk preferojnë të vet-identifikohen me termin LGBTI.
- Questioning: persona që nuk janë të sigurt për orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor dhe që janë ende duke eksploruar këto identitete. Shpesh ato kanë vështirësi edhe në përdorimin e njërit apo tjetrit term për veten e tyre;
- Interseks: është një term që përdoret për persona të cilët kanë lindur me karakteristika fizike, riprodhuese dhe gjenitale, që nuk janë strikt mashkullore apo femërore. Në gjuhën popullore përdoret edhe termi hermafroditë;
- Aseksual: person që nuk përjeton tërheqje seksuale ndaj askujt dhe që ka pak ose aspak interes në aktivitete seksuale;
- Aleatë: persona jo-LGBTI të cilët mbështesin kauzën dhe janë shpesh aktivistë;
- Panseksual: person që përjeton tërheqje fizike, emocionale dhe romantike ndaj personave të tjerë pavarësisht seksit apo gjinisë së tyre.

Në një botë ideale, pa diskriminim dhe dallim, njerëzit nuk do të kishin nevojë të përkufizoheshin në bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor të tyre. Por ndërkohë që jetojmë ende në kushtet e pabarazisë dhe diskriminimit që vendos personat LGBTI në kushte jo-të favorshme përdorimi i termit LGBTI është kthyer në një element force për shumë persona. Ky mund të quhet një tranzicion që e merr emërtimin nga jashtë, në një kohë kur ka diskriminim dhe paragjykim, dhe brendësohet në formë krenarie nga personat në fjalë.



ORIENTIM SEKSUAL

Orientimi seksual përshkruan një model/strukturë të qëndrueshme tërheqjeje – emocionale, romantike dhe seksuale ose kombinim i tyre – kundrejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja seksve ose asnjërit prej seksve dhe gjinive që i shoqërojnë ato. Këto tërheqje qëndrojnë përgjithësisht nën emërtimet heteroseksualitet, homoseksualitet, biseksualitet dhe aseksualitet. Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë, orientimi seksual i referohet gjithashtu ndjenjës së “identitetit personal dhe shoqëror” të personit, bazuar në një nga këto tërheqje, sjelljeve që i shprehin ato dhe anëtarësimit në komunitete me persona që i ndajnë ato.

Koncepti i orientimit seksual, ka të bëjë me shumë më tepër sesa thjesht sjelljen seksuale. Në të përfshihen si ndjenjat ashtu edhe identiteti. Disa individë mund ta identifikojnë veten e tyre si gej, lesbike ose biseksualë edhe pa u përfshirë në ndonjë aktivitet seksual. Disa njerëz besojnë se orientimi seksual është i lindur dhe i përcaktuar, ndërsa studime të tjera tregojnë se orientimi seksual zhvillohet përgjatë jetës së njeriut.

Shumë njerëz vet-identifikohen si heteroseksualë, gej, lesbike ose biseksualë në momente të ndryshme të jetës së tyre. Orientimi seksual është një term që përdoret shpesh për të përshkruar tërheqjen romantike, emocionale apo seksuale të një personi ndaj një personi tjetër. Dikush që tërhiqet nga persona të të njëjtit seks ka orientim homoseksual dhe mund të quhet gej ose lesbike. Individët që tërhiqen nga persona të seksit të kundërt kanë orientim heteroseksual. Orientimi seksual është një proces që thellohet vazhdimisht me kalimin e kohës dhe individët që tërhiqen si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat quhen biseksualë. Orientimi seksual është i ndryshëm nga identiteti gjinor, i cili i referohet ndjesive të brendshme që tregojnë se dikush është mashkull ose femër.

IDENTITET GJINOR

Identiteti gjinor është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjinore, si për shembull të jesh burrë ose grua, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. Identiteti gjinor bazë, formohet zakonisht rreth moshës tre-vjeçare dhe është jashtëzakonisht i vështirë për tu ndryshuar pas kësaj moshe. Të gjitha shoqëritë kanë një grup të kategorive gjinore që mund të shërbejnë si bazë e formimit të një identiteti social në raport me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Në shumicën e shoqërive, ekziston një ndarje bazë ndërmjet attributeve gjinore të caktuara për meshkujt dhe femrat.

Megjithatë, në të gjitha shoqëritë njerëzore, disa individë nuk identifikohen me gjininë që u është caktuar nga seksi i tyre biologjik.

SHKALLA “KINSEY”

Shkalla “Kinsey” është një shkallë vlerësimi mbi sjelljen seksuale të meshkujve dhe femrave. Sipas kësaj shkalle, në varësi të sjelljes së tyre, njerëzit ndodhen në një shkallë heteroseksual-homoseksual, me vendndodhjen biseksual në mes. Në vitet 1980 në këtë renditje u shtua edhe një kategori e veçantë për personat aseksualë.

Në vitet 1940, duke intervistuar njerëzit për historitë e tyre seksuale Kinsey zbuloi se për shumë njerëz sjellja seksuale, mendimet dhe ndjenjat kundrejt seksit të njëjtë apo të kundërt nuk ishin të qëndrueshme me kalimin e kohës. Edhe pse pjesa më e madhe e burrave dhe grave raportonin se ishin ekskluzivisht heteroseksualë dhe një pjesë tjetër se ishin ekskluzivisht homoseksualë, shumë individë ndanë histori që tregonin se ndodheshin diku midis të dyja orientimeve.

Tabela 1 shpjegon shkallën e vlerësimit Kinsey:

ALFRED KINSEY LE TË FLASIM PËR SEKSUALITETIN	
Njehsimi	Përshkrimi
0	Totalisht Heteroseksual
1	Përgjithësisht heteroseksual, vetëm me raste homoseksual
2	Përgjithësisht heteroseksual por më shumë se një rast homoseksual
3	Biseksual
4	Përgjithësisht homoseksual, vetëm me raste heteroseksual
5	Përgjithësisht homoseksual por më shumë se një rast heteroseksual
6	Totalisht Homoseksual
X	Aseksual, jo-seksual
Alfred Kinsey është personi që filloi për seksin në vitet 1930 Studimet mbi këtë temë ai i kreu pranë Universitetit të Indianës, në SHBA. Dr. Kinsey studjoi sjelljen seksuale tek njerëzit për qëllime shkencore. Ky ka qenë një nga studimet e para të këtij lloji dhe rezultatet e tij vëzhgohen edhe në ditët e sotme. PRO SMITHSONIAN PINK PINK	

Figure 1 Shkalla e vlerësimit Kinsey

- 0 – ekskluzivisht heteroseksual/e pa asnjë eksperiencë homoseksuale
- 1 – kryesisht heteroseksual/e, vetëm rastësisht homoseksual/e
- 2 – kryesisht heteroseksual/e, por më shumë se rastësisht homoseksual/e
- 3 – njësoj heteroseksual/e dhe homoseksual/e
- 4 – kryesisht homoseksual/e por më shumë se rastësisht heteroseksual/e
- 5 – kryesisht homoseksual/e, vetëm rastësisht heteroseksual/e
- 6 – ekskluzivisht homoseksual/e
- X – Aseksual/e

Sipas Kinsej: “Meshkujt nuk përbëjnë dy popullsi të ndryshme, heteroseksuale dhe homoseksuale. Bota nuk është e ndarë në dele dhe dhi... Bota e gjallë është një vazhdimësi në të gjitha aspektet e saj”. Në vitin 1953 ai shtoi se “është karakteristikë e mendjes njerëzore që ti ndajë dhe kategorizojë gjërat [bardh e zi]. Sjellja seksuale nuk është as normale as anormale, as e pranueshme as e papranueshme, heteroseksuale apo homoseksuale dhe shumë njerëz nuk duan të besojnë se në të tilla çështje ka renditje dhe grada që i vendosin njerëzit në njërin ekstrem apo tjetrin.”

PERSONI “GENDERBREAD”

Modeli i personit “genderbread” është shumë i suksesshëm dhe praktik për të shpjeguar orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Për më shumë shihni Tabelën 2. Gjithashtu për ushtrime dhe praktika interesante vizitoni faqen www.itspronouncedmetrosexual.com.

The Genderbread Person

by www.ItsPronouncedMetrosexual.com





Tabela 2 Personi “Genderbread”

Edhe pse modeli genderbread është vlerësuar si jo i plotë dhe thjeshtëzues në raport me spektrin e identiteteve njerëzore, ai shërben për të kuptuar disi më qartë ndryshimet e rëndësishme midis gjinisë, seksit dhe orientimit seksual.

Mjetet e Ushtrimit

- Tabelë / board
- Person genderbread pa përshkrim
- Personi genderbread i plotësuar
- Laps

QËLLIMI I PERSONIT “GENDERBREAD”

- Të bëhet dallimi midis orientimit seksual L, G, B dhe identitetit gjinor T;
- Të bëhet dallimi midis seksit, identitetit gjinor, shprehjes së identitetit gjinor dhe tërheqjes;
- Të ndihmojë pjesëmarrësit në botëkuptimin e tyre mbi seksin, identitetin gjinor, shprehjen e gjinisë, tërheqjen si dhe gjykimet apo paragjykimet e tyre mbi këto karakteristika.

Kur diskutojmë çështjen LGBTI harrojmë të qartësojmë se nuk po flasim për një person të veçantë dhe se termat lesbike, gej, biseksual, transgjinor dhe interseks përfaqësojnë identitete të ndryshme. Disa persona vet-identifikohen me disa prej këtyre përkufizimeve, për shembull gej dhe transgjinor, ose me disa, për shembull lesbike, queer dhe transgjinor.

L, G dhe B janë identitete seksuale, ndërsa T ka të bëjë me identitetin gjinor. T është gjithashtu një term ombrellë për të gjitha llojet e identiteteve gjinore. Ndërkohë me termin “identitete seksuale” nënkuptojmë mënyrat se si ne kategorizojmë dhe përshkruajmë personat me të cilët jemi të tërhequr emocionalisht, seksualisht apo tjetër. Kur themi “identitete gjinore” po flasim për mënyrat e ndryshme sesi mund të kategorizohen gjinitë.

Tradicionalisht, ne përdorim termin “gjini” duke nënkuptuar thjesht një “burrë” ose “grua”. Ky njihet edhe si “binariteti gjinor”. Por mënyra se si njerëzit e përfetojnë gjininë në realitet është më komplekse. Ky njihet si kuptim “jo-binar” i gjinisë. Por termat binarë dhe idetë që ato evokojnë – ideja e një “burri” dhe se çfarë ajo do të thotë dhe ideja e një “gruaje” dhe se çfarë ajo do të thotë, ndihmojnë për të kuptuar mënyrat e ndryshme se si njerëzit përfetojnë dhe i japin kuptim gjinisë.

Një mënyrë e thjeshtëzuar për të kuptuar gjininë jo-binare është përmes një shkalle burrë-grua, në të cilën njerëzit mund të vendosin se çfarë dhe si ndihen më shumë në atë shkallë. Ndoshta më afër me “burrë” nëse ndihen më tepër si meshkuj dhe më afër me “grua” nëse ndihen më shumë si femër, ose diku ndërmjet nëse identifikohen si genderqueer, bigender etj.

Problemi me këtë paraqitje të gjinisë është se ajo prezumon që sa më shumë dikush të jetë “burrë” atëherë aq më pak do të jetë “grua”. Sipas modeleve tradicionale ne duam të besojmë se kjo është e vërtetë, por kur e shpërbëjmë gjininë në të gjitha pjesët e saj, (ashtu si në tabelën e mësipërme) atëherë kuptojmë se kjo nuk është domosdoshmërisht e vërtetë.

Siç shihet në tabelë, gjinia kuptohet më mirë kur ndahet në tre pjesë: identitet gjinor (që ka të bëjë me mënyrën se si ju vet-identifikoheni në mendjen tuaj), shprehje gjinore (që ka të bëjë me mënyrën se si ju visheni, silleni, etj) dhe seksi biologjik (pjesët fizike të trupit tuaj të cilat ne i identifikojmë si mashkull ose femër).

Ti shohim këto një nga një:

Identiteti gjinor mund të mendohet si aspekte burrë-rie apo gra-rie me të cilat një person identifikohet ose jo. Në këtë rast ne po flasim për normat (pritshtëritë sociale) dhe rolet (mënyrat se si ne i paraqesim ato pritshtëritë) e caktuara për “burrat” dhe “gratë” në një shoqëri. Disa stereotipe që lidhen ngushtë me të qenurit burrëror mund të jenë “vullnet-fortë, logjik, atletik” dhe role të tilla si “lider, ndërtues, mbrojtës”. Për gra-rinë mund të mendojmë për norma të tilla si “e dashur, e ndjeshme, e kujdesshme” dhe role si “më-suese, kujdestare, ndihmëse”. Disa njerëz nuk vet-identifikohen me asnjërën nga këto, por me një gjini të tretë. Disa njerëz identifikohen me pak nga të dyja dhe mund ta kenë të vështirë të përdorin termin burrë apo grua për të përshkruar identitetin e tyre.

Shprehja e gjinisë mund të mendohet si shprehje e karakteristikave mashkullore apo femërore të tilla si veshja, sjellja, fjalët, mënyra e të folurit etj. Përshembull veshje mashkullore mund të konsiderohen pantallona të gjera dhe që janë funksionale. Veshje femërore mund të jenë të ngushta apo shumëngjyrëshe. Termi “androgjen” përdoret shpesh për të thënë se një person ka shprehje gjinore femërore dhe mashkullore bashkë.

Seksi biologjik ka të bëjë me karakteristika “mashkullore” apo “femërore” që shfaqen në fizikun tonë. Shembuj të karakteristikave mashkullore janë elementë parësorë si “penisi, testikujt” ndërsa karakteristika dytësore janë elemente si lesh në trup, shpatulla të gjera etj. Shembuj të karakteristikave femërore janë elementët parësorë si “vagina apo vezoret” dhe elementë dytësorë si “gjoksi, vithe të gjera” etj. Disa njerëz janë kryesisht meshkuj ose kryesisht femra, kurse disa të tjerë janë interseks.



Heteronormativiteti

Një nga mënyrat për të kuptuar problemet me diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor është të diskutohet dhe vihet në pikëpyetje heteronormativiteti. Ky term është përdorur për herë të parë në vitin 1991 dhe është besimi se njerëzit i përkasin dy kategorive gjinore komplementare (burrë dhe grua) me role natyrale në jetë. Sipas heteronormativitetit, heteroseksualiteti është i vetmi orientim seksual ose e vetmja normë, dhe mbron idenë se marrëdhëniet seksuale dhe martesore janë më të përshtatshme (ose vetëm të përshtatshme) për çifte me sekse të ndryshme. Për rrjedhojë një këndvështrim “heteronormativ” nënkupton vendosjen në një rresht të seksit biologjik, seksualitetit, identitetit gjinor dhe roleve gjinore. Heteronormativiteti lidhet shpesh me heteroseksizmin dhe homofobinë.

HETEROSEKSIZMI DHE HOMOFOBIA

Nga Ermal Mara

Heteroseksizmi, një lojtar i shkathët që përdor një nga armët më efikase të Seksizmit, homofobinë. Sipas heteroseksizmit bota është dhe duhet të jetë heteroseksuale dhe norma e rregullimit të marrëdhënieve midis popullatës është shfaqja e fuqisë dhe ndarja e privilegjeve, kjo krijon një klimë të përshtatshme për homofobinë. Heteroseksizmi është shfaqja sistematike e homofobisë në institucionet e shoqërisë.

Nuk është rastësi që brezat e rinj në moshën e pubertetit, kur njohin pikun e vetëdijes seksuale, fillojnë të ngacmojnë njëri-tjetrin me fjalë si “pederast”, “homo” etj. Kjo ndodh sepse në pubertet shfaqet forca e vërtetë e presionit të shoqërisë për të qenë konform me heteroseksualitetin dhe për t’u martuar. Fëmijët dinë atë që u mësohet dhe të gjithë u kemi dhënë mesazhe të qarta për ata që dalin jashtë standardit: të kthehen përsëri në “vijë”. Taktika e presionit psikologjik më e mirë në moshën e pubertetit është të jesh i trajtuar si një i jashtëm, të ndihesh i padëshiruar pikërisht kur është më e nevojshme të jesh i pranuar. Ata që janë të ndryshëm duhet të ndjejnë “humbjen”. Gjithashtu, në pubertet misogjinia bëhet më e dukshme dhe vajzat janë nën presionin për të qenë brenda normave shoqërore të cilat nuk i lënë vend atyre për të kuptuar potencialin e tyre të plotë. Kjo është periudha kur arritjet akademike bien në përgjithësi.

Në Shqipëri nuk ka patur një revolucion seksual dhe ende sot dy janë akuzat të cilat mund ta gjymtojnë moralisht një femër: kurvë dhe lesbike. E para përdoret si kërcënim seksual dhe tregues pronësie nga ana e meshkujve, ndërsa e dyta është një kërcënim total i cili e zhvesh femrën nga çdo fuqi dhe privilegj, kërcënimi e të qenit e huaj, e braktisur, e pambrojtur.

Lesbiket dhe Gejt: Një kërcënim për shtyllën e Seksizmit

Një lesbike perceptohet si një femër që ka dalë nga turma, e cila është jashtë varësisë seksuale dhe ekonomike të mashkullit. Një lesbike perceptohet si një femër jashtë të pranueshmes, jashtë rutinës gjinore. Ajo shikohet si një individ pa institucione shoqërore për ta mbrojtur dhe që nuk ka privilegjin e mbrojtjes së plotë të meshkujve individualë. Shumë femra heteroseksuale i shikojnë ato si dikush në kundërshti me sakrificat që ato kanë bërë për të qenë konform me heteroseksualitetin. Një lesbike perceptohet si një kërcënim për bërthamën familjare, për sundimin dhe kontrollin e meshkujve, për vet shtyllën e seksizmit.

Meshkujt gej perceptohen gjithashtu si një kërcënim për sundimin dhe kontrollin e meshkujve dhe homofobia e shfaqur ndaj tyre ka të njëjtat rrënjë në seksizëm si homofobia kundër lesbikeve. Meshkujt gej të dukshëm (bëhet fjalë për ata që kanë dalë hapur) janë edhe shënjestra e frikës dhe urrejtjes ekstreme prej meshkujve heteroseksualë, sepse ata thyejnë solidaritetin e burrave e kjo gjithë shihet dëmtuese për një seksizëm të fortë. Ata shihen si të pabesë, tradhëtarë që duhen dënuar dhe eliminuar. Mes rrahjeve dhe vrasjeve e meshkujve gej shihen qartë provat e kësaj urrejtjeje. Kur bëhemi dëshmitarë të homofobisë ndaj gejeve, mund të fillojmë të kuptojmë se në ç’mënyrë seksizmi ndikon mbi meshkujt duke u imponuar role gjinore të ngurta dhe depersonalizuese.

Dy rrethanat në të cilat është legjitime për meshkujt të jenë fizikisht dashamirës ndaj njëri-tjetrit janë sportet dhe krizat ushtarake/luftërat. Për shumë meshkuj, këto dy eksperiencat janë majat më të larta të jetës së tyre dhe ata i mendojnë shpesh sportet me nostalgji. Lufta dhe sporti afrojnë një mbrojtje për shprehjen hapur të dashurisë ndaj tjetrit në një ambjent vetëm me meshkuj pa qenë nevoja e lidhjes të kësaj sjelljeje me heteroseksualitetin. Kur meshkujt gej fillojnë të krijojnë lidhje dashurore jashtë zonave të sigurta, ata etiketohen si “burra jo të vërtetë”, pra identifikohen si femra, seksi i dobët që duhet të dominohet dhe që përgjatë shekujve ka qenë objekt i urrejtjes dhe abuzimit të burrave. Misogjinia kalohet tek homoseksualët si hakmarrje dhe përforcohet nga frika se mos sjellja dhe identiteti seksual i tyre do të rrëzojë sistemin e sundimit të mashkullit dhe heteroseksualitetit të detyruar.

INTERSEKSIONALITETI

Është studimi i ndërlidhjeve midis formave dhe sistemeve të ndryshme të shtypjes, dominimit dhe diskriminimit. Sipas interseksionalitetit, eksperiencat e të qenurit femër dhe lesbike nuk mund të shihen si dy gjëra të ndara por si dy faktorë që ndërlidhen shpesh me njëra-tjetrën dhe që shpesh forcojnë njëra-tjetrën. Interseksionaliteti, përpiket të vërejë se si kategoritë e ndryshme sociale, biologjike dhe kulturore, të tilla si gjinia, raca, klasa, aftësia, orientimi seksual, besimi fetar, kasta dhe të tjerë elementë të identitetit ndërveprojnë në nivele të shumëfishtë dhe shpesh të njëkohshëm, duke kontribuar në padrejtësi sistematike dhe pabarazi shoqërore. Sipas interseksionalitetit, konceptualizimet klasike shtypëse në shoqëri, të tilla si seksizmi, homofobia dhe transfobia nuk ndërveprojnë të pavarura nga njëra tjetra, përkundrazi këto forma shtypje ndërlidhen dhe krijojnë një sistem shtypje i cili reflekton edhe “interseksionalitetin” e formave të ndryshme të diskriminimit.

Mite dhe fakte për personat lesbike, gej dhe biseksualë

Tabela e mëposhtme paraqet stereotipet dhe paragjykimet e zakonshme me të cilat përballen personat LGB si dhe paraqet faktet reale të cilat hedhin poshtë konceptet tradicionale të formuara në shoqëri:

Paragjykimet më të zakonshme	Përgjigje
Homoseksualiteti është sëmundje.	Organizata Botërore e Shëndetësisë gjykoi para 20 vjetësh se homoseksualiteti nuk është sëmundje.
Homoseksualiteti është anormalitet, një çrregullim i personalitetit.	Studimet e shumta mjekësore dhe shkencore vërtetojnë se homoseksualiteti është një variant natyral i sjelljes njerëzore.
“Pavarësisht stereotipeve të forta që i portretizojnë personat lesbike, gei, biseksuale si njerëz me shqetësime, kërkimet shkencore dhe klinike të kryera ndër dekada i kanë shtyrë organizatat mendore dhe shëndetësore të vendit tonë të arrijë në përfundimin se këto orientime përfaqësojnë forma më se normale të sjelljes njerëzore.” (Shoqata Amerikane e Psikologjisë)	
Homoseksualiteti është imoralitet	Ky është një këndvështrim subjektiv i mbështetur në dogma fetare. Kjo nuk mund të shërbejë si arsye për të kufizuar të drejtat e të tjerëve, në një shoqëri demokratike.
Homoseksualiteti po rritet si fenomen	Numri i personave lesbike, gej dhe biseksualë nuk është në rritje. Ata thjesht po bëhen më të dukshëm në shoqëri.
Sipas qeverisë britanike 5-7% e popullsisë së atij vendi janë lesbike, gej ose biseksualë. Më dobësimin e diskriminimit, shumë njerëz janë më të hapur për orientimin e tyre seksual, duke dhënë përshtypjen e gabuar se numrat po rriten.	
Homoseksualiteti po e përkeqëson krizën demografike dhe kërcënon të ardhmen e kombit.	Të fajësosh një komunitet të vogël për shkak të problemeve demografike është jo-logjike dhe shërben vetëm për ti shpërqëndruar njerëzit nga problemet e vërteta.

Nuk ka asnjë lidhje midis mbështetjes për të drejtat e komunitetit LGBT dhe problemeve demografike. Në fakt, vendet nordike, që janë edhe më të suksesshmet në zgjidhjen e problemeve demografike, ofrojnë një mbështetje të madhe në mbrojtjen e personave lesbike, gei dhe biseksualë, ndërkohë vendet që kanë qenë me shtypëse ndaj këtij komuniteti vuajnë edhe problemet më të mëdha.

Njohja ligjore e çifteve të të njëjtës gjini përbën rrezik për familjen tradicionale.

Të lejosh martesat mes çifteve të të njëjtës gjini, nuk influencon apo çënon vendimin e personave heteroseksualë për tu martuar apo patur fëmijë.

“Familja tradicionale” (pra ajo e përbërë nga një burrë, grua dhe fëmijë) ka pësuar rënie në shumë vende europiane sepse shumë çifte heteroseksuale zgjedhin të mos martohen, të divorcohen dhe sepse shumë çifte heteroseksuale vendosin të mos bëjnë fëmijë. Të lejosh çiftet e gjinisë së njëjtë të martohen do ndikojë në këtë trend vetëm në lidhje me uljen në numër të martesave të shtirura të cilat shumë lesbike dhe gej i bëjnë për ti shpëtuar opinionit. Nuk duhet të harrojmë se shumë shpesh këto martesa përfundojnë në divorce të dhimbshme.

Propaganda mund ti konvertojë të rinjtë në homoseksualë.

Nuk ka asnjë fakt që të mbështesë këtë këndvështrim.

Nëse 1600 vite persekutimesh dhe përndjekjesh – përfshi këtu dënimin me vdekje, burgosjen, diskriminimin dhe përjashtimin shoqëror nuk kanë arritur të “konvertojnë” personat homoseksualë në heteroseksualë, atëherë dhënia e informacionit për homoseksualitetin me siguri që nuk do ketë asnjë ndikim në orientimin seksual të personave heteroseksualë, pavarësisht moshës së tyre.

Homoseksualët janë rrezik për fëmijët

Personat lesbike, gej dhe biseksualë mund të përbëjnë kërcënim për fëmijët po aq sa mund të përbëjnë edhe personat heteroseksualë.

Akademia Amerikane e Psikiatrisë për Fëmijët dhe Adoleshentët ka vërejtur se nuk ka asnjë fakt që të vërtetojë se personat lesbike dhe gej përbëjnë ndonjë rrezik për zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe ka dënuar çdo diskriminim të ushtruar ndaj personave lesbike dhe gej në rastet kur ata kanë aplikuar në pozicione pune që ofrojnë shërbime dhe trajtime për fëmijët dhe adoleshentët (shkolla, spitale etj).

Mite dhe fakte për personat trans

Paragjykimet më të zakonshme

Personat e rinj në moshë nuk mund ta dinë identitetin e tyre gjinor.

Të rinjtë identifikohen si trans për te qenë trendi.

Të gjithë personat trans janë të bardhë

Personat trans e fshehin identitetin e tyre të “vërtetë”

Përgjigje

Për shkak të ndërgjegjësimit të hershëm mbi çështjet e personave trans shumë njerëz të rinj kanë gjetur forcën dhe kurajon për të shprehur identitetin e tyre në moshë të hershme.

Të vet-identifikohesh si trans sjell shumë sfida dhe diskriminim. Nuk mund të jetë kurrësi diçka për të qenë “interesantë” apo “trendi”.

Personat trans ose që nuk përputhen me normat gjinore vijnë nga të gjitha kategoritë social-ekonomike, raciale, etnike dhe fetare.

Personat transgjinorë nuk mashtrojnë të tjerët duke folur hapur për identitetin e tyre gjinor. Kur një person po kryen tranzicionin nga mashkull në femër apo anasjelltas, ai/ajo po ndërmerret një hap të madh dhe të vështirë në jetë për të cilin duhet inkurajuar dhe mbështetur.

Personat trans janë thjesht gej

Siç shpjegohet më sipër orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë dy gjëra të ndryshme. Tërheqja seksuale ka të bëjë me tërheqjen romantike ndaj burrave, grave ose të dy gjinive. Identiteti gjinor ka të bëjë me vet-përkufizimin e një individi si mashkull, femër apo një gjini midis mashkullit dhe femrës. Ashtu si personat jo trans, edhe personat trans mund të jenë të çfarëdolloj orientimi seksual.

Të gjithë personat trans duhet të marrin hormone dhe të kryejnë ndërhyrje kirurgjikale

Disa persona trans preferojnë të marrin hormone dhe të kryejnë ndërhyrje kirurgjikale e disa të tjerë jo. Disa persona ndihen komodë me mënyrën se si duken. Për shumë persona të tjerë ndërhyrjet hormonale dhe kirurgjikale janë të pamundura për shkak të kostos së lartë apo pengesave të tjera burokratike.

Gratë trans nuk janë gra të “vërteta” dhe burrat trans nuk janë burra të “vërtetë”

Gjinia e “vërtetë” e njerëzve nuk ka të bëjë me seksin që u caktohet në lindje. Gjinia jonë e vërtetë bazohet në identitetin tonë gjinor. Kur një person trans paraqet një identitet të ndryshëm nga ai që i është caktuar në lindje, ata janë duke shprehur identitetin e tyre të vërtetë.

Nuk është problem të tallesh me vajza që janë shumë mashkullore dhe djem që janë shumë femëror. Është thjesht shaka dhe nuk shkakton asnjë dëm.

Ngacmimet nuk janë asnjëherë të padëmshme sidomos ato në lidhje me stereotipet gjinore. Personat që nuk sillen sipas pritshmërive gjinore të shoqërisë shpesh e kanë shumë të qartë identitetin e tyre. Shfaqja apo sjellja e tyre mund të duket çoroditëse, thjesht sepse nuk përputhet me stereotipet që njerëzit kanë për gjininë.

PJESA 2

SITUATA LIGJORE E KOMUNITETIT LGBTI

SITUATA LIGJORE E KOMUNITETIT LGBTI

Komuniteti i Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve e Transgjinatorëve në Shqipëri duhet të gëzojë të drejta e liri në mënyrë të barabartë me të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Shqipëria ka firmosur e ratifikuar një numër Konventash Ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, por edhe të drejtave të komunitetit LGBT në veçanti. Shqipëria ka hartuar edhe legjislacionin e saj kombëtar në një linjë me këto Konventa, por realiteti tregon se Konventat Ndërkombëtare apo Legjislacioni Kombëtar jo gjithnjë zbatohen.

Për tu zbatuar një Konventë Ndërkombëtare apo Ligj Kombëtar së pari duhet të njihet e të kuptohet nga ata që duhet ta zbatojnë atë, si dhe nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut që vazhdimisht monitorojnë e ngrenë zërin në mbrojtje të këtyre të drejtave.

Materialet e mëposhtme bëjnë prezente ekzistencën e legjislacionit ndërkombëtar e kombëtar në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të Komunitetit LGBT.

AKTET NDËRKOMBËTARE TË RATIFIKUARA NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në nenin 116, pika 2 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon që për nga fuqia juridike aktet ndërkombëtare vijnë menjëherë pas Kushtetutës. Kjo krijon mundësinë që të gjitha grupet e interesit dhe individët ti referohen dokumentave të rëndësishme ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut.

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT dhe OKB

Edhe pse Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut nuk i përmend specifikisht të drejtat e personave LGBTI, shumë nga nenet e saj dhe të traktateve që kanë pasuar në Kombet e Bashkuara janë të aplikueshme konkretisht edhe për këtë komunitet. Për shembull Deklarata inkurajon “respekt për të drejtat dhe liritë themelore të të gjithëve pa asnjë lloj dallimi”. Në mënyrë të ngjashme neni 2 thotë se “të gjithë kanë të drejta dhe liri që përfshihen në këtë deklaratë”. Edhe pse jo të gjitha shtetet e botës e kanë de-kriminalizuar homoseksualitetin, Kombet e Bashkuara kanë nisur përpjekjet e tyre, dhe së fundmi është bërë progres i mjaftueshëm në avancimin e mbrojtjes ligjore të të drejtave LGBT. Vetë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki Moon është prononcuar shpesh në mbrojtjen nga diskriminimi të qytetarëve për shkak të orientimit seksual dhe identitetit të tyre gjinor. Puna e tij në 4 vitet e fundit ka patur ndikim pozitiv në përjasjen e OKB-së ndaj kësaj çështje.

Ban Ki Moon dhe drejtues të shumë shteteve kanë folur përpara OKB-së në mbrojtje të të drejtave të personave LGBT duke argumentuar se të drejtat e personave LGBT janë të drejta të njeriut dhe se nuk janë të ndara njëra nga tjetra. Një nga argumentat e mbrojtësve të të drejtave LGBT është se megjithë respektin për kulturën, traditat dhe besimet e shumë popujve, ato vlera dhe tradita nuk duhet të shërbejnë për të shkelur të drejtat e njeriut dhe nuk duhet të shërbejnë si pretekst për të mohuar të drejtat themelore të qytetarëve, përfshi këtu orientimin seksual dhe identitetin gjinor të tyre.

Brenda Kombeve të Bashkuara është bërë një deklaratë në kuadrin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 17 dhjetor 2008, e mbështetur nga 66 shtete, e cila dënon shkeljet e të drejtave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të tilla si vrasjet, tortura, arrestimet arbitrare, mohimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë dhe të drejtën e gëzimit të shëndetit. Kjo shënon dhe deklaratën e parë mbi këtë temë nga Asambleja e Përgjithshme.

Reporterë specialë të Kombeve të Bashkuara kanë shprehur shqetësimin për situatën e komunitetit LGBTI. Deklarata e OKB-së mbi “Orientimin seksual dhe identitetin gjinor” është nënshkruar nga Shqipëria më 18 Dhjetor 2008.

Një nga arritjet më të rëndësishme të OKB-së në mbrojtjen e të drejtave LGBT është miratimi në Shtator 2014 nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, i Rezolutës për të Drejtat LGBT. Pas një procesi votimi të vështirë dhe kundërshtimeve të disa shteteve, rezoluta u miratua me 25 vota pro dhe 14 vota kundër. Kjo mungesë unanimiteti ka qenë edhe një nga arsyt pse OKB e ka ende të vështirë të punojë më sistematikisht në mbrojtje të të drejtave LGBT.

Një nga arritjet pozitive të kësaj rezolute ishte se mjaft shtete, të cilat historikisht kanë qenë në blloqet kundër të drejtave LGBT kanë ndryshuar bindjet, shpesh duke përmirësuar përjasjen e tyre politike dhe ligjore ndaj këtij komuniteti. Një nga rezultatet e këtij raporti do të jetë prodhimi i një raporti global mbi situatën e të drejtave të personave LGBT.

PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE (PNDKP)

I miratuar më 16 Dhjetor 1966 me rezolutën 2200A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme, në Nenin 26 thekson se “ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër.

KONVENTA MBI ELEMENIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRUAS

E ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 1994 dhe Protokolli Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2003. Ky është Komiteti për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) i cili ka përcaktuar se diskriminimi i gruas për shkak të seksit dhe gjinisë është i lidhur me shkaqe të tjera ndër të cilat edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është deklarata e nënshkruar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 Dhjetor 1948. Deklarata ishte rezultat i drejtpërdrejtë i Luftës së Dytë Botërore dhe është i pari dokument botëror i cili parashtron të drejtat e të gjithë qenieve njerëzore.
<http://www.coe.int/t/dg4/lgbt/Source/EM-ALBANIA.pdf>, faqe 2

KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

I ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 1992, Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve në Komentin e Përgjithshëm nr. 4 ka parashikuar shprehimisht orientimin seksual si shkak për të cilin ofrohet mbrojtja e fëmijëve në kuadër të kësaj Konvente.

DEKLARATA E MONTREALIT

Është një dokument i miratuar në Montreal, më 29 korrik, 2006, nga Konferenca Ndërkombëtare mbi të Drejtat LGBT. Deklarata përcakton një numër të të drejtave dhe lirive që kanë të bëjnë me personat LGBT, të drejta që propozohen të jenë të garantuara në mënyrë universale. Ajo përfshin të gjitha aspektet e të Drejtave të Njeriut, nga garantimi i lirive themelore deri në parandalimin e diskriminimit të personave

LGBT në shëndetësi, arsim dhe emigracion. Deklarata gjithashtu adreson çështjet e ndryshme që kërcënojnë promovimin global të të drejtave LGBT.

Konferenca synoi të rriste ndërgjegjësimin e komunitetit ndërkombëtar për çështjet e të drejtave LGBT. Në të morën pjesë më shumë se 1500 delegatë nga e gjithë bota, duke e bërë konferencën më të madhe të të drejtave të LGBT të mbajtur ndonjëherë. Një numër i ekspertëve ndërkombëtarë morën pjesë duke përfshirë edhe juristë të shquar, akademikë, krerët e kishës dhe aktivistë të të drejtave të njeriut. Deklarata u miratua unanimisht nga delegatët.

Deklarata kishte për qëllim të adresonte mungesat e vazhdueshme të OKB-së në zbatimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Një numër lirish themelore, përfshi të drejtën e jetës, ishin shkelur në një numër vendesh anëtare, ku homoseksualiteti konsiderohej krim. Aktet homoseksuale, në kohën e mbajtjes së Konferencës, ishin të dënueshme me vdekje në nëntë juridiksione: Afganistan, Republikën Çeçene, Iran, Nigeri, Mauritania, Pakistan, Arabinë Saudite, Sudan dhe Jemen, ndërkohë që ishin të paligjshme në 72 vende dhe në shumë raste të dënueshme me burgim ose dënime trupore.

TË DREJTAT THEMELORE

Mbrojtja nga dhuna shtetërore dhe private

Deklarata bën thirrje për dhënien fund të dënimit me vdekje dhe të dhunës kundër personave LGBT qoftë nga shteti ose palët private. Shtetet duhet të ndërmarrin hapa për të mbrojtur personat LGBT nga të gjitha krimet e urrejtjes. Martesat e detyruara me persona të seksit të kundërt janë identifikuar si një dhunim i të drejtave të njeriut, i cili duhet të luftohet. Së fundi, dhuna ndaj interseksualëve, përmes kirurgjisë së panevojshme për të detyruar përputhjen me modelet e ngurta të karakteristikave seksuale, është e dënueshme sikurse dhe kirurgjia e organeve gjenitale të tyre, me përjashtim të rasteve kur ata janë në moshë të pjekur dhe japin pëlqimin e tyre. Ky element u pasqyrua në Nenin 18 (mbrojtja nga abuzimi mjekësor) të Parimeve të Jogakartës.

Liria e shprehjes, mbledhjes dhe shoqërimit

Ligjet që diskriminojnë personat LGBT, të tilla si ato që pengojnë paradat/marshimet e tyre, gazetarinë LGBT dhe regjistrimin e OJQ-ve, janë identifikuar si pengesa të mëdha në fushatën për të drejtat e LGBT. Për rrjedhojë komunitetit botëror i kërkohet të garantojë të tilla të drejta dhe të parandalojë mohimin e tyre nga autoritetet armiqësore publike. Përveç kësaj, bashkësisë ndërkombëtare i kërkohet të ndërmarrë hapa pozitive në promovimin e të drejtave të tilla. Për këtë qëllim, Deklarata bën thirrje që paketat ndërkombëtare të ndihmës për zhvillim të kushtëzojnë përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe ato të personave LGBT. Të shihet mundësia e ndihmës financiare për grupet që bëjnë fushatë për të drejtat e LGBT në zonat ku personat ende ndjejnë frikë për jetën e tyre dhe sigurinë personale. Ndihma financiare janë kërkuar për grupet e fushatës për të drejtat e LGBT në zonat ku njerëzit e tillë ende kane frikë për jetën ose sigurinë e tyre personale.

Liri për tu angazhuar në aktivitete seksuale me persona me gjini të njëjtë

Shfuqizim i të gjitha ligjeve që ndalojnë aktivitetin seksual me persona të të njëjtit seks.

Liria nga diskriminimi

Komuniteti LGBT përballet me diskriminim në shumë aspekte të jetës. U bëhet thirrje qeverive që të promovojnë të drejtat e LGBT për të qenë të lirë nga diskriminimi në fushat e mëposhtme:

- **Të drejtat për azil dhe emigracion**

Komisioneri i Lartë për Refugjatët në Kombet e Bashkuara njih të drejtën e azilit të personave të persekutuar për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. U bëhet thirrje të gjitha vendeve të bëjnë të njëjtën gjë. Për më tepër, të drejtat e qëndrimit për partnerët e huaj, persona LGBT, nuk duhet të diskriminohen.

- **Te drejtat familjare**

Familja është pjesa më e rëndësishme e jetës së shumë njerëzve. Deklarata kërkon që martesat të jenë të hapura për çiftet e të njëjtit seks, të gjitha çiftet e pamartuara të kenë të drejta të barabarta partneriteti dhe shanse të barabarta për mundësinë e të qenit prind, përfshirë birësimet nga personat LGBT.

- **Edukata shëndetësore, media dhe punësimi**

Në arsim, kurrikula duhet të përfshijë edhe të drejtat e njeriut të personave LGBT dhe shkollat duhet të ndërmarrin veprime kundër etiketimeve homofobe. I bëhet thirrje medias për të ndihmuar në thyerjen e stereotipeve dhe për të portretizuar njerëzit LGBT në një mënyrë realiste. Theksohet nevoja për aksesin në kujdesin shëndetësor në përgjithësi dhe për nevojat specifike të personave LGBT. Në veçanti duhet që financimet për operacionet për ndryshimin e gjinisë të jenë në të njëjtën masë si për trajtimet e tjera të nevojshme mjekësore. Së fundi, nxiten grupet fetare që të jenë tolerantë ndaj personave LGBT.

- **Punësimi**

Deklarata bën thirrje për zhvillimin e programeve për të promovuar shanse të barabarta në punësim dhe biznes për personat LGBT në mënyrë që të sigurohet pavarësia e tyre ekonomike. Qeverive u kërkohet të japin shembullin e tyre në eliminimin e diskriminimeve të tilla dhe në promovimin e barazisë dhe sigurisë së personave LGBT që punojnë në sektorin publik.

- **Çështjet globale në promovimin e të drejtave të LGBT**

Për të promovuar të drejtat e LGBT në nivel global, Deklarata i kërkon komunitetit ndërkombëtar të angazhohet në një fushatë informimi në mbarë botën dhe u bën thirrje OJQ-ve dhe qeverive që kanë të njëjtin mendim që të ndihmojnë në përgatitjen dhe drejtimin e një fushate të tillë. Pjesë e kësaj fushate mund të jetë edukimi mbi parandalimin dhe trajtimin e HIV/AIDS ndër personat LGBT dhe përgjithësisht nxiten qeveritë që të përfshijnë personat LGBT në luftën kundër HIV/AIDS.

Dënohet dështimi i Kombeve të Bashkuara në njohjen e të drejtave të LGBT si të drejta të njeriut. I kërkohet Këshillit të ri të të drejtave të Njeriut të OKB-së të miratojë të drejtat e komunitetit LGBT si pjesë e axhendës së tij.

PRINCIPET E JOGAKARTËS

Principet e Jogakartës janë një set Principesh që lidhen me mënyrën se si legjislacioni ndërkombëtar është i aplikueshëm për njerëzit me orientim seksual dhe identitet gjinor të ndryshëm. Principet janë përgatitur nga një grup ekspertësh të cilët u mbledhën në Jogakarta të Indonezisë dhe parashtrojnë obligimet e shteteve për tu siguruar që personat LGBTI mund të gëzojnë të drejtat e tyre ashtu si gjithë personat e tjerë në shoqëri. Principet nuk krijojnë të drejta të reja por janë një artikulum i të drejtave të njeriut. Ato bazohen në të drejtën ndërkombëtare ashtu si ai reflektohet në traktate ndërkombëtare, jurisprudencën e organeve të krijuara nga këto traktate si gjykata dhe komisione, interpretime ligjore nga raportues specialë që punojnë me grupe të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, opinione të ekspertëve dhe praktikat më të mira të shteteve.

Principet synojnë të jenë të qarta në qëllimin e tyre, si për të drejtat që mbulojnë ashtu edhe në lidhje me eksperiencat jetësore të personave LGBTI. Kjo ishte e mundur falë kombinimit të ekspertizës së realizuesve të saj, eksperiencën e të drejtave të shkelura për shkak të këtyre karakteristikave si dhe falë njohjes së detajuar të ligjeve për të drejtat e njeriut.

Principet e Jogakartës janë të rëndësishme sepse ato përqasin legjislacionin ndërkombëtar me situatën konkrete të shkeljeve të të drejtave të njeriut që pësojnë personat LGBTI.

Principet e Jogakartës janë 29:

1. e drejta për gëzim universal të të drejtave të njeriut
2. e drejta për barazi dhe mos-diskriminim
3. e drejta për tu njohur përpara ligjit
4. e drejta për të jetuar
5. e drejta për sigurinë e personit
6. e drejta për privatësi
7. e drejta për të qenë të lirë nga privimi arbitrar i lirisë
8. e drejta për gjykim të drejtë
9. e drejta për tu trajtuar me dinjitet gjatë kohës së burgimit
10. e drejta për liri nga tortura dhe trajtimi apo ndëshkimi mizor, jo njerëzor dhe degradues
11. e drejta për tu mbrojtur nga të gjitha format e shfrytëzimit, shitjes dhe trafikimit të qenieve njerëzore
12. e drejta për punësim
13. e drejta për siguri sociale dhe masa të tjera për mbrojtje sociale
14. e drejta për standarte të përshtatshme të jetesës
15. e drejta për strehim
16. e drejta për arsimim
17. e drejta për të patur standartin më të lartë të shëndetit
18. mbrojtje nga abuzimet mjekësore
19. e drejta për liri të mendimit dhe të shprehjes
20. e drejta për liri të mbledhjes dhe shoqërimit
21. e drejta për liri mendimi, ndërgjegje dhe besimi
22. e drejta për liri lëvizjeje
23. e drejta për të kërkuar azil
24. e drejta për të krijuar familje
25. e drejta për të marr pjesë në jetën publike
26. e drejta për të marr pjesë në jetën kulturore
27. e drejta për të marr pjesë në jetën kulturore
28. e drejta për kompensim dhe masa riparuese
29. llogaridhënie

Përmbledhje e Parimeve:

Parathënie:

Parathënia përmbledh shkeljet e të drejtave të njeriut të bazuara në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, kuadrin ligjor të kësaj fushe, si dhe përkufizon termat kyç.

E Drejta për të gëzuar të Drejtat Universale të Njeriut, Mos-Diskriminimi dhe Njohja përpara Ligjit:

Parimet 1 deri në 3 përcaktojnë parimet e universalitetit të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të tyre ndaj të gjithë personave pa diskriminim, si dhe i të drejtës të të gjithë njerëzve për tu njohur si person/individ përpara ligjit.

Shembull: Të tilla janë ligjet që kriminalizojnë homoseksualizmin dhe dhunojnë të drejtën ndërkombëtare të mos-diskriminimit (Vendim i Komitetit të të drejtave të Njeriut të OKB).

Të drejtat e Sigurisë Humane dhe Personale:

Parimet 4 deri në 11 adresojnë të drejtat themelore të jetës, lirisë pa dhunë dhe torturë, privatësisë, aksesit në drejtësi dhe lirisë kundrejt burgosjes arbitrare.

Shembuj:

- Dënimi me vdekje vazhdon të zbatohet për aktivitetin seksual konsensual të personave madhorë mes personave të të njëjtit seks, pavarësisht se rezolutat e OKB-së theksojnë që dënimi me vdekje mund të mos përdoret për “marrëdhënie seksuale mes moshave madhore që pranojnë”;
- 11 persona u arrestuan në një bar për gej dhe u mbajtën në burg për rreth një vit. Grupi i Punës së OKB-së për Burgosjen Arbitrare konkludoi se personat ishin burgosur në kundërshtim me ligjin ndër kombëtar dhe nënvizon me shqetësim se “një prej të burgosurve vdiq në burg për shkak të këtij burgimi arbitrar”.

Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore:

Parimet 12 deri në 18 përcaktojnë rëndësinë e mos-diskriminimit në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore duke përfshirë punësimin, strehimin, sigurinë sociale, edukimin, shëndetin dhe ricaktimin e gjinisë.

Shembuj:

- Gratë lesbike dhe transgjinore janë nën rrezikun në rritje të diskriminimit, dhunës dhe mungesës së strehimit (Raport i Raportuesit Special të OKB-së mbi strehimin e përshtatshëm).
- Vajzat që shfaqin afeksion ndaj të njëjtit seks ndeshen me diskriminim dhe përjashtim nga institucionet arsimore (Raport i Raportuesit Special të OKB-së mbi të drejtën për arsim).
- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut ka shprehur shqetësim për ligje të cilat “ndalojnë operacionin për transeksualët ose i kërkojnë personave interseks të nënshtrohen këtyre operacioneve kundër dëshirës së tyre”.

E Drejta e Shprehjes, Opinionit dhe Shoqatave:

Parimet 19 deri në 21 theksojnë rëndësinë e lirisë së shprehjes, identitetit dhe të seksualitetit të çdo individi, pa ndërhyrjen e shtetit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, përfshirë të drejtat e pjesëmarrjes paqësore në Asamblëtë dhe eventet publike, si dhe të mbledhjes në komunitet.

Shembull:

- Një tubim paqësor për promovimin e barazisë bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor u ndalua nga autoritetet dhe pjesëmarrësit ishin të lodhur e të frikësuar nga policia dhe ekstremistët nacionalistë të cilët hidhnin parrulla të tilla si “të kapim pederastët” dhe “Ne do të bëjmë për ju atë që Hitleri e bëri me hebrenjtë” (Raporti i Raportuesit Special të OKB-së mbi format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë dhe intolerancës).

Liria e Lëvizjes dhe e Azilit:

Parimet 22 dhe 23 theksojnë të drejtat e personave për të kërkuar azil për shkak të persekutimit që e ka bazën tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor.

Shembull:

- Mbrojtja e refugjatëve duhet ti akordohet personave që përballen me frikën për shkak të orientimit seksual (Udhëzimet e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët).

Të drejtat e pjesëmarrjes në jetën kulturore dhe atë familjare:

Parimet 24-26 adresojnë të drejtat e personave për të marr pjesë në jetën familjare, çështjet publike dhe në jetën kulturore të komunitetit të tyre, pa u diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Shembull:

- Shtetet kanë detyrim të mos diskriminojnë në pikëpamjen e marrëdhënieve mes seksit të ndryshëm dhe mes të njëjtit seks kur bëhet fjalë për përfitime të tilla si pensioni i personave që jetojnë akoma (vendimi i Komisionit të të Drejtave të Njeriut).

Të drejtat e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut:

Parimi 27 njeh të drejtën për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut, pa diskriminuar në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe detyrimin e shteteve për të siguruar mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut që punojnë në këto fusha.

Shembull:

- Mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë në çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor në vende dhe rajone të gjithë botës “janë kërcënuar, u janë plaçkitur shtëpitë dhe zyrat, janë sulmuar, torturuar, abuzuar seksualisht, kërcënuar me vdekje dhe madje edhe i kanë vrarë. Një shqetësim i madh në këtë drejtim është një mungesë pothuajse e plotë e seriozitetit me të cilin këto raste janë trajtuar nga autoritetet përkatëse.” (Raporti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut).

Të drejtat e Kompensimit dhe Llogaridhënies:

Parimet 28 dhe 29 afirmojnë rëndësinë e marrjes së masave ligjore ndaj shkelësve të të drejtave, dhe të sigurimit të kompensimit të përshtatshëm për ata që përballen me dhunimin e të drejtave.

Shembull:

- Komisioneri i lartë i OKB për të Drejtat e Njeriut ka shprehur shqetësimin në lidhje me “mos-ndësh kimin e krimeve ndaj personave LGBT” dhe “përgjegjësinë e shtetit për të zgjeruar mbrojtjen efektive. “Komisioneri i Lartë vë në dukje se “duke përjashtuar individët e komunitetit LGBT nga këto masa mbrojtëse në mënyrë të qartë shkelen të drejtat ndërkombëtare të njeriut, si dhe standardet e përbashkëta të njerëzimit “

Rekomandime Shtesë:

Parimet përcaktuan 16 rekomandime shtesë për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, strukturat profesionale, financuesit, OJQ-të, Komisionerin e Lartë për të Drejtat e Njeriut, agjencitë e OKB-së etj.

Shembull:

- Parimet njohin përgjegjësinë e një numri të gjerë aktorësh për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për të integruar këto standarde në punën e tyre. Kështu për shembull, më 1 dhjetor 2006 iu dërgua Këshillit të Kombeve të Bashkuara të të Drejtave të Njeriut një deklaratë e përbashkët nga 54 shtete, nga katër prej pesë rajoneve të OKB-së, dhe kjo Deklaratë i kërkon Këshillit të të Drejtave të Njeriut të “kushtojë vëmendjen e duhur rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, la vërejtje në punën e shoqërisë civile në këtë fushë dhe u bën thirrje “të gjitha palëve në traktat që të vijojnë në përputhje me mandatin e tyre të mbajnë në konsideratë shkeljet e të drejtave të njeriut për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”. Siç thekson kjo deklaratë, dhe afirmojnë parimet e Jogakartës, mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut është realisht përgjegjësi e të gjithëve.

Parimet e Jogakartës u bënë publike në formën e kartës botërore për të drejtat e LGBT në 26 Mars 2007 në Gjenevë dhe u prezantuan në Kombet e Bashkuara në 7 Nëntor 2007.



REKOMANDIMET 2010 (5) I KIE

Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor është miratuar më 31 Mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave.

Organe të ndryshme të Këshillit të Evropës kanë miratuar tekste të shumta mbi këtë temë për rreth tridhjetë vjet. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka miratuar rekomandime të shumta për Komitetin e Ministrave që prej vitit 1981 si dhe po përgatit aktualisht brenda Komisionit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut një raport për “Diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”.

Rekomandimi 2010 (5) është instrumenti i parë i hartuar nga Komiteti i Ministrave, i cili trajton specifikisht çështjen e diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

Ky rekomandim i fton shtetet anëtare të garantojnë zbatimin e parimeve dhe masave të parashikuara në shtojcë, në legjislacionin, politikat dhe praktikat kombëtare të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të lesbikeve, gej-ve, biseksualëve dhe transeksualëve dhe me rritjen e tolerancës ndaj këtij grupi social.

Në bazë të principeve dhe parimeve ligjore e politike të shteteve anëtarë të Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave u rekomandon shteteve anëtare:

1. të shqyrtojnë masat ekzistuese legjislative dhe masat e tjera, t’i mbajnë ato në rishikim të vazhdue shëm, të mbledhin dhe të analizojnë të dhënat përkatëse në mënyrë që të monitorojnë dhe të trajtojnë çdo rast diskriminimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor;
2. të sigurojnë miratimin e masave legjislative dhe masave të tjera si dhe zbatimin e tyre efektiv për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor dhe për të siguruar respektimin e të drejtave njerëzore të lesbikeve, gej-ve, biseksualëve dhe transgjinorëve dhe për të nxitur tolerancën mes tyre;
3. të sigurojnë se viktimat e diskriminimit janë të informuar dhe mund të përdorin mjetet efektive ligjore para një organi kombëtar dhe se masat për luftimin e diskriminimit përfshijnë, aty ku është e nevojshme, sanksionet për shkeljet dhe ofrimin e kompensimit të nevojshëm për viktimat e diskriminimit;
4. të udhëhiqen në legjislacionin, politikat dhe praktikën e tyre nga parimet dhe masat e përfshira në shtojcën e këtij rekomandimi;
5. të sigurojnë nëpërmjet mjeteve dhe veprimeve të përshtatshme se ky rekomandim, duke përfshirë dhe shtojcën e tij, përkthehen dhe shpërndahen sa më gjerësisht të jetë e mundur.

Ndërkohë rekomandimet pasohen me një listë shtojcash të cilat bazohen tek të drejtat themelore të njeriut dhe që vënë theksin tek puna konkrete që duhet bërë në këto fusha:

- I. E drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna;
 - II. Liria e organizimit;
 - III. Liria e shprehjes dhe tubimit paqësor;
 - IV. E drejta e respektimit të jetës private dhe jetës familjare;
 - V. Punësimi;
 - VI. Arsimi;
 - VII. Shëndeti;
 - VIII. Strehimi;
 - IX. Sportet;
 - X. E drejta për të kërkuar azil;
 - XI. Struktura kombëtare për të drejtat e njeriut;
 - XII. Diskriminimi për shkaqe të shumëfishta.
-

DEKLARATA E IDAHOT

Në 14 Maj 2014, Qeveria e Shqipërisë përkrah qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Malit të Zi, nënshkroi në Valeta të Maltës deklaratën e angazhimit me synim luftimin e homofobisë e transfobisë dhe mbrojtjen e avancimin e të drejtave të personave LGBT.

Ky dokument nis me besimin se të gjithë qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta. Të gjithë kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat e tyre, pavarësisht orientimit seksual apo identitetit gjinor.

Vendet shprehën angazhim për parimin e universalitetit të të drejtave të njeriut dhe rikonfirmojnë se vlerat kulturore, tradicionale dhe fetare nuk mund të përdoren për të justifikuar çfarëdolloj forme diskriminimi, duke përfshirë diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Personat lesbike, gej, biseksualë, trans dhe interseks (LGBTI) përbëjnë grupe të ndryshme dhe vulnerabël, të cilët në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, vazhdojnë të jenë viktimat të urrejtjes, dhunës, diskriminimit, bulizmit dhe keqtrajtimit.

Shtetet pranu se një angazhim i posaçëm është i nevojshëm për të luftuar homofobinë, bifobinë, transfobinë dhe intolerancën që buron prej tyre.

Shtetet mirëpresin nismat ndërkombëtare të mara për të promovuar të drejtat e personave LGBT, dhe rikonfirmojmë se kjo deklaratë nuk i zëvendëson ato dokumenta.

Për sa më sipër, shtetet nënshkruese synojnë të:

1. Garantojnë që të ndërmeren dhe implementohen efektivisht masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
2. Të sigurojnë që të drejtat e lirisë së shprehjes dhe mbledhjes të jenë të garantuara, veçanërisht aktivitetet publike si marshimet e krenarisë, duke bërë të mundur që ato të zhvillohen paqësisht dhe duke garantuar mbrojtjen e plotë të pjesëmarrësve;
3. Rregjistrojnë, hetojnë dhe ndjekin penalisht të gjitha krimet e urrejtjes të bazuara në orientimin seksual dhe identitetin gjinor dhe ti dënojnë publikisht këto krime, kur kjo është e përshtatshme;
4. Të sigurohen që e drejta e arsimimit të personave LGBT të gëzohet efektivisht dhe të lirë nga diskriminimi, të pandaluar nga stereotipet gjinore dhe të lirë nga dhuna, bulizmi, përjashtimi social apo forma të tjera trajtimi diskriminues dhe degradues që lidhen me orientimin seksual dhe identitetin gjinor;

5. Të heqin të gjitha pengesat që ndalojnë të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
6. Të garantojnë njohjen e plotë ligjore të identitetit gjinor të një personi në të gjitha fushat e jetës, veçanërisht duke mundësuar ndërrimin e emrit dhe gjinisë në dokumentat zyrtare në një mënyrë të shpejtë, transparente dhe të arritshme;
7. Të heqin çdo kërkesë abuzive apo jo-proporcionale për njohjen ligjore të gjinisë, të bëjnë të disponueshme të gjithë shërbimet e duhura për ricaktimin e gjinisë dhe të garantojnë që askush të mos bëhet subjekt i procedurave të ricaktimit të gjinisë pa miratimin e vetë personit;
8. Të mirëpresin iniciativat ndërkombëtare që synojnë rritjen e nivelit të dijeve mbi situatën e të drejtave të personave interseks;
9. Të ngrejë çështjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar dhe të bashkëpunojnë me shtete të tjera apo organizatat e duhura ndër-qeveritare për të adresuar homofobinë dhe transfobinë përtej kufijve;
10. Të miratojnë masa për promovimin e barazisë së personave LGBTI në nivel kombëtar dhe mbështetjen e strategjive të nivelit rajonal dhe ndërkombëtar kur është e përshtatshme;
11. Të promovojnë barazinë në të gjitha nivelet e qeverisjes, me fokus të veçantë tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor dhe rrisin ndërgjegjësimin publik mbi diversitetin dhe përfshirjen në të gjitha nivelet e shoqërisë, duke nisur nga mosha të reja;
12. Të bashkëpunojnë dhe konsultohen me organizatat jo-qeveritare që mbrojnë të drejtat e personave lesbike, gej, biseksualë, transgjinorë dhe interseks për miratimin dhe zbatimin e masave që mund të kenë ndikim në të drejtat e personave LGBTI dhe të sigurohen që të gjithë aktorët e shoqërisë civile që punojnë mbi të drejtat LGBTI tu garantohet një mjedis i sigurt dhe mundësues, në ligj dhe praktikë, për të zhvilluar funksionet e tyre legjitime dhe për të operuar të lirë nga pengesat apo pasiguritë.

TË DREJTAT LGBT NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE VENDET KANDIDATE

Të drejtat LGBT në Bashkimin Evropian mbrohen nga traktatet dhe ligjet e Bashkimit Evropian. Nenet 10 dhe 9 të Traktatit mbi Funksimin e Bashkimit Evropian parashikojnë luftimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Më tej, neni 21 i Konventës për të Drejtat Themelore ndalon diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Homoseksualiteti është i ligjshëm në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe diskriminimi në vendin e punës është i ndaluar që në vitin 2000. Gjithsesi shtetet e BE-së kanë ligje të ndryshme në lidhje me mbrojtjen, të drejtën e martesës dhe adoptimin e fëmijëve.

Brenda Bashkimit Evropian, Neni 13 i Traktatit që themelon Komunitetin Evropian e përfshin orientimin seksual në listën e shkaqeve për diskriminim. Po ashtu Neni 21(1) i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian përfshin një dispozitë të përgjithshme kundër diskriminimit, e cila përmend shprehimisht “orientimin seksual” në listën e shkaqeve të ndaluara. Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar një direktivë që përcakton një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion, i cili mbulon shprehimisht orientimin seksual. Aktualisht po punohet për propozimin e një direktive për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për punësim në fusha të ndryshme ndërmjet personave pavarësisht nga feja, besimi, paafësia, mosha ose orientimi seksual.

Ndërkohë direktivat e BE-së nuk ofrojnë ende mbrojtje në fushën e shëndetësisë, akomodimit në një hotel, mbrojtje nga bulizmi në shkollë apo refuzimi për tu përfshirë në skemat e mbrojtjes sociale. Qytetarët LGBT duhet të mbështeten në legjislacionin kombëtar për të kërkuar mbrojtje në këto fusha.

Ndërkohë, pavarësisht mbështetjes së dhënë nga Parlamenti Evropian, Këshilli i Ministrave ose Këshilli i Bashkimit Evropian nuk ka miratuar ende një ligj evropian anti-diskriminimi i cili do ta bënte të paligjshëm diskriminimin në fushat e mbrojtjes sociale, avantazheve sociale, arsimit dhe aksesin në të mira e shërbime. Ky ligj do të ofronte mbrojtje mbi baza të besimit fetar, aftësisë së kufizuar, moshës dhe orientimit seksual.

Bashkimi Evropian e ka vendosur respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, veçanërisht grupet vulnerabël si ato LGBT, si një nga 5 prioritetet në raport me integrimin e mëtijshëm të vendit në union.

LEGJISLACIONI KOMBËTAR

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

“Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me 04.02.2010 dhe hyri në fuqi më 13.03.2010. Ky ligj është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumentave ndërkombëtare dhe njëkohësisht një hap konkret i përmbushjes së standarteve të anëtarësimin në BE. Për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, ligji ka krijuar institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

I udhëhequr nga vizioni “Të jetojmë në një shoqëri ku respektohet parimi i barazisë dhe promovohet barazia e shanseve dhe e mundësive”, misioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këto vite ka qenë mbrojtja nga diskriminimi përmes: - ofrimit të ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim; - rritjes së ndërgjegjësimit nëpërmjet informimit për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje dhe zhvillimit të dialogut të rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë dhe organizatat jo-qeveritare; - publikimit të raporteve dhe dhënies së rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Tashmë disa nga vendimet e Komisionerit kanë formuar vendime model të mbështetura edhe në vendimet e Gjykatës së Strasburgut apo në respekt të parimeve të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, si:

- Vendime për diskriminim në formën e viktimizimit në marrëdhëniet e punës;
- Vendime për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore dhe përkatësisë prindërore;
- Vendime për diskriminim përmes gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT apo pakicave kombëtare;
- Vendime diskriminimi për shkak të bindjeve fetare;
- Vendime diskriminimi në arsim për shkak të aftësisë së kufizuar apo përkatësisë në komunitetin rom;
- Vendime diskriminimi në ushtrimin e të drejtës së zgjedhjeve përmes “mohimit të përshtatjes së arsyeshme”;
- Vendime diskriminimi për shkak të gjinisë në ofrimin e shërbimeve.

Pas 5 vitesh nga miratimi i tij, ligji ka gjetur zbatim edhe në gjykata. Numri i çështjeve gjyqësore me pretendim diskriminimi në gjykata ka ardhur duke u rritur veçanërisht gjatë vitit 2014 dhe veçanërisht në fushën e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është rritur edhe ndërgjegjësimi i gjykatave për thirrjen e Komisionerit për dhënien e opinioneve me shkrim apo rezultatet e procedimeve administrative në rastet kur Komisioneri ka zhvilluar një hetim administrativ. Zbatimi i ligjit tregon për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe informimin mbi rrugët ligjore për të siguruar mbrojtjen nga diskriminimi.

Megjithatë rritja e ndërgjegjësimit për zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe informimin mbi rrugët ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi vazhdon të jetë një sfidë e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitet në vazhdim.

PJESË NGA LIGJI Nr.10 221, datë 04.02.2010 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Kreu I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Objekti: Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 2

Qëllimi: Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

Përkufizimet: 1. “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

3. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

4. “Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

5. “Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

6. “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

7. “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

8. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë.

9. “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizatat të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.

RAPORT I VEÇANTË PËR MBROJTJEN DHE RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETIT LGBTI NË SHQIPËRI

Në Janar 2015 zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi bëri publik një raport të veçantë për komunitetin LGBT.

Më poshtë janë rekomandimet e Komisionerit:

1. Përmirësimi i legjislacionit shqiptar për shmangien e diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në përputhje me aktet ndërkombëtare, legjislacionin evropian dhe Ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Është e rëndësishme të bëhen kërkime dhe të mblidhen të dhëna për masat dhe praktikat diskriminuese, në veçanti kur bëhet fjalë për “krimet e urrejtjes” dhe “incidentet e motivuara nga urrejtja” për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, duke mbajtur parasysh të drejtën për respektimin e jetës private. Reflektimi në statistikën e policisë i krimeve për shkak të orientimit seksual.
3. Ndërgjegjësimi i shoqërisë në përgjithësi dhe grupeve të veçanta mbi të drejtat e komunitetit LGBT me synim nxitjen e debatit të papajtuësëm me përdorimin e gjuhës së urrejtjes;
4. Duhet të sigurohemi se viktimat e diskriminimit janë të informuar dhe mund të përdorin mjetet efektive ligjore;
5. Realizimi i sondazheve dhe monitorimeve mbi respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT në fusha të ndryshme si arsim, punësim dhe shërbime. Përfshirja në kurrikulat/ekstra kurrikulat e shkollës e të drejtave të komuniteti LGBT si të drejtat e njeriut; rishikimi i teksteve shkollërore me përmbajtje diskriminuese; monitorime dhe studime për çështjet e diskriminimit/bulizmit/dhunës që përfshijnë edhe orientimin seksual etj.;
6. Përfshirja e figurave publike (gazetarë, politikanë, arsimtarë...) në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT me synim nxitjen e modeleve pozitive;
7. Trajnimi i aktorëve të ndryshëm për trajtimin me barazi dhe mosdiskriminim të komunitetit si punonjësit e policisë, punonjësit e shëndetësisë, mësuesit e psikologët, nëpunësit e pushtetit vendor, gjyqtarët.

KODI I PUNËS

Pas një pune intensive të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizatat LGBT në vend, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ndryshime të Kodit të Punës duke ofruar mbrojtje nga diskriminimi në vendin e punës për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Konkretisht në pikën 2 të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” përfshiu si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.

KODI PENAL

Në vitin 2013 Parlamenti i Shqipërisë bëri ndryshimet e para në Kodin Penal që nga miratimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Konkretisht ndryshimi i parë ka të bëjë me përfshirjen si rrethanë rënduese të një krimi edhe motivimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, pra mbron edhe komunitetin transgjinor. Ky ndryshim bëhet në Nenin 50, paragrafi J i Kodit i cili ndryshohet si më poshtë:

j) “kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”

Pra nëse një krim i ndodhur ka për motivim një nga karakteristikat e mësipërme atëherë rrethanat quhen rënduese dhe dënimi është më i madh. Madje edhe në rastet kur ndaj një personi të shpallur fajtor ka rrethana lehtësuese, në rast se krimi është bërë për një ose më shumë nga karakteristikat e mësipërme, atëherë personi nuk përfiton ulje dënimi por shtim të dënimit.

Ndryshimi i dytë ka të bëjë me përfshirjen në Kodin Penal të konceptit të krimeve ndaj personave LGBTI përmes teknologjisë së informacionit. Neni 119/a parashikon një krim të ri në listën e veprave penale.

Konkretisht për këtë vepër penale parashikimet janë si më poshtë:

119/a “Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit e komunikimit, e materialeve me përmbajtje raciste, homofobike, ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

KODI I FAMILJES

Ndërkohë që Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë nuk ka bërë ende ndryshimet e duhura për të qenë në përputhje me ligjin anti-diskriminim, MMSR, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë bërë rekomandimet e posaçme për ndryshime të posaçme që do të lejonin çiftet e të njëjtit seks të bashkëjetonin ligjërisht. Deri tani ky propozim është pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk ka një datë se kur ky propozim do të shqyrtohet nga Parlamenti i Shqipërisë.

Propozimi për ndryshime i MMSR sugjeron ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 05.08.2003 “Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë” të bëhen këto ndryshime:

“Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis dy personave që jetojnë në çift e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe qëndrueshmërie”

Neni 164 të ndryshohet si më poshtë:

“Kushtet dhe procedura e regjistrimit, pasojat e regjistrimit, mënyrat e përfundimit të bashkëjetesës dhe marrëdhëniet personale e pasurore ndërmjet bashkëjetuesve rregullohet me ligj të veçantë”.

Sipas MMSR ndryshimet ligjore të mësipërme konsistojnë në dy aspekte kryesore të institutit të bashkëjetesës:

- Ndryshimi i parë ka të bëjë me legalizimin e bashkëjetesës së faktit edhe për personat që i përkasin të njëjtës gjini dhe në këtë mënyrë kjo sjell ndryshimin e nenit 163 të Kodit të Familjes

dhe

- Ndryshimi i dytë që ka të bëjë me mundësinë për të parashikuar rregullim me anë të një ligji të veçantë të aspekteve lidhur me kushtet, procedurën, regjistrimin si dhe pasojat personale dhe pasurore që sjell bashkëjetesa dhe në këtë mënyrë ndryshimin e nenit 164 të Kodit të Familjes.

Pra, në këtë mënyrë, këto ndryshime të propozuara efektojnë vetëm përmbajtjen e neneve 163 dhe 164 të Kodit të Familjes.

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara është që ti përgjigjet standardeve të lirisë dhe të barazisë e mos diskriminimit në çështjet që lidhen me gëzimin e jetës familjare. Gjithashtu qëllimi i këtyre ndryshimeve është që garantojë parimin kushtetues të nënvizuar në nenin 53/1 se “kushdo ka të drejtë [të martohet dhe] të ketë familje” dhe të nenit 52/2 se “[martesa dhe] familja gëzon mbrojtjen e veçantë nga shteti”. Këto ndryshime paraqiten bazuar në një analizë tërësore të kuadrit ligjor shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare si dhe të situatës faktike lidhur me institutin e bashkëjetesës.

NJOHJA LIGJORE E GJINISË

Njohja Ligjore e Gjinisë është njohja zyrtare e identitetit gjinor të një personi, përfshi këtu gjininë dhe emrin apo emrat në regjistrat zyrtarë dhe dokumenta kyç personalë dhe publikë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka marrë shpesh vendime dhe është shprehur pozitivisht për njohjen ligjore të gjinisë me qëllim mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtave të personave trans.

Personat transgjinorë apo trans kanë një identitet gjinor i cili nuk përkon me gjininë që u është caktuar në lindje. Kjo përfshin edhe persona të cilët synojnë të kryejnë, janë duke kryer apo kanë kryer ndryshimin fizik të gjinisë si edhe ata të cilët preferojnë të paraqiten ndryshe nga pritshmëritë që lindin prej gjinisë që u është caktuar në lindje.

Shqipëria nuk ka patur dhe nuk disponon asnjë ligj specifik që ka të bëjë me njohjen ligjore të gjinisë. Në terma praktikë kjo do të thotë se personat transgjinorë nuk mund të jetojnë në një mënyrë që të përshtatet me gjininë në të cilën ata duan të jetojnë dhe që ju përket. Për shembull një person trans që është femër por që ka lindur në trupin e një mashkulli dhe që është regjistruar si fëmijë me gjininë “mashkull” nuk mund të ketë një kartë identiteti apo pasaportë që ti korrespondojë gjinisë femër apo emri të një femre. Gjithashtu personi në fjalë nuk mund të ndryshojë patentën, diplomën e shkollës apo universitare etj. Këto janë të gjitha pengesa ligjore, administrative dhe proceduriale që ndikojnë negativisht në jetën e një personi trans.

Propozime të MMSR “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 05.08.2003 ”Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. Legal Gender Recognition in Europe, Toolkit, Transgender Europe, http://www.tgeu.org/sites/default/files/Toolkit_web.pdf

Ndërkohë, legjislacioni evropian ndër vite ka rezultuar të ketë shumë probleme për faktin se është konsideruar diskriminues dhe negativ në praktikë. Në mjaft shtete evropiane ndryshimi ligjor i gjinisë mund të ketë një ose disa parakushte që janë diskriminuese ose dëmtuese për mirëqenien emocionale dhe fizike të një personi, të tilla si:

- Diagnozë për çrregullim mendor;
- Trajtime mjekësore dhe ndërhyrje kirurgjikale;
- Vërtetim që ka jetuar mjaftueshëm në gjininë e kërkuar;
- Që është beqar/e (pra që duhet të divorcohet në rast se është i/e martuar)
- Kërkesë për sterilizim, etj.

Të tilla kërkesa shkelin dinjitetin e një personi, integritetin fizik, të drejtën për të krijuar familje dhe për të qenë i/e lirë nga çdo formë trajtimi degradues dhe çnjerëzor.

Për shkak të punës së gjatë avokuese të organizatave trans dhe LGBT në njohjen e këtyre çështjeve tashmë mjaft vende kanë prezantuar ligje të reja për njohjen ligjore të gjinisë të cilat kanë eliminuar këto praktika diskriminuese ose kanë bërë amendime të ligjeve ekzistuese për njohjen ligjore të gjinisë.


Zyra e Këshillit të Evropës në Shqipëri, Avokati i Popullit dhe organizatat LGBT kanë punuar së bashku me disa nga ekspertët më të mirë në përgatitjen e një projektligji i cili përshtatet me praktikën më të mirë e që janë jo-diskriminuese, të shpejta dhe respektuese të dinjitetit dhe integritetit njerëzor. Aktualisht ky projektligj nuk është marrë në shqyrtim nga Ministritë përkatëse.



Shqipëria dhe Europa

Shqipëria është një rast i veçantë në lidhje me avancimet e mëdha që ka bërë në ndryshimet dhe përmirësimet ligjore për komunitetin LGBT si dhe në ushtrimin e aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe promovuese të organizatave LGBT. Ndërkohë që statistikën në seksionin tjetër do të tregojnë një realitet të rëndë mbi këtë komunitet sidomos në raport me paragjykimet dhe diskriminimin, ndryshimet ligjore dhe politike në vend tregojnë se Shqipëria ka bërë progres i cili duhet të vijojë edhe në të ardhmen.

Më poshtë është “Harta Ylber” e ILGA Europë organizatës më të madhe LGBT në Evropë anëtare e së cilës është edhe Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri.



Kjo hartë vlerëson arritjet e shteteve evropiane në fushat e barazisë dhe mosdiskriminimit, familjes, fjalimit e urrejtjes dhe dhunën, njohjen ligjore të gjinisë, lirinë e shprehjes dhe mendimit dhe të drejtën për të kërkuar azil politik mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Institucionet në mbrojtje të komunitetit LGBTI

Avokati i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar për herë të parë në Kushtetutën Shqiptare të miratuar në Nëntor 1998, kurse ligji “Për Avokatin e Popullit” është miratuar nga Parlamenti Shqiptar në shkurt të vitit 1999. Ky ligj është hartuar duke patur parasysh dhe legjislacionin e vendeve të tjera të Evropës, të cilat e kanë krijuar më parë një Institucion të tillë. Drejtimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është monokratik. Avokati i Popullit zgjidhet nga tre të pestat e gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të çdo personi nga veprimet e paligjshme, ose të parregullta të administratës publike. Çdo individ ose grup individësh përfshirë edhe fëmijët e mitur, në çdo rast kur dikush gjykon se është viktimë e një gabimi ose padrejtësie, mund ti drejtohet me ankesë Avokatit të Popullit.

Qytetarët LGBTI kanë të drejtë ashtu si çdo qytetar tjetër i Republikës së Shqipërisë që ti drejtohen këtij institucioni për çdo rast shkelje të të drejtave të tyre nga institucionet e administratës publike.

Avokati i Popullit ka publikuar një Raport të Veçantë për komunitetin LGBT në Gusht 2012, dhe disa rekomandime në lidhje me ndryshime dhe përmirësime në Kodin e Punës, Kodin Penal, Kodin e Familjes dhe në Dhjetor 2013 publikoi studimin e posaçëm mbi cilësinë e aksesit në shërbime mjekësore të personave LGBT. (shiko referencat)

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Veprimtaria e Komisionerit realizohet nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të subjekteve që pretendojnë se janë viktimë të sjelljeve diskriminuese apo që e nxisin atë, jo vetëm nga administrata publike, por edhe nga subjektet private. Gjithashtu, Komisioneri realizon hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji dhe bën sondazhe dhe monitorime për nivelin e zbatimit të ligjit. Procedurat e hetimit administrativ pasohen nga rekomandime dhe në rast të moszbatimit të tyre vendosen edhe sanksione sipas parashikimeve ligjore. Te gjitha këto shoqërohen me aktivitete që synojnë informimin dhe sensibilizimin e komunitetit, organeve të administratës publike dhe subjekteve private për të nxitur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka publikuar një raport të veçantë për komunitetin LGBT në Janar 2015, disa rekomandime për ndryshime dhe përmirësime në Kodin e Punës dhe Kodin Penal. KMD ka trajtuar çdo vit raste të diskriminimit me viktimë individë të komunitetit LGBT, fjalimet e urrejtjes dhe diskriminuese në media etj.

Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrinë e tjera përgjegjëse për avancimin e të drejtave të komunitetit LGBT

MMSR është institucioni kryesor përgjegjës për rritjen e mirëqenies sociale të personave LGBT. Politikat e saj në lidhje me punësimin, shërbimet sociale (mbrojtjen dhe përfshirjen sociale), ndryshimet dhe përmirësimet ligjore në Kodin e Punës etj. Ndërkohë ky institucion është garant edhe për përfshirjen e tematikës LGBT dhe qytetarëve LGBT në politikat e rinisë, kujdesit dhe përfshirjes sociale, rritjen dhe zhvillimin profesional etj.

Policia e Shtetit

Siguria dhe mbrojtja nga dhuna dhe sulmet e urrejtjes mbetet një çështje prioritare për komunitetin LGBT. Në kuadër të rritjes së vizibilitetit të tyre në shoqëri është e domosdoshme edhe rritja e kapaciteteve të policisë së Shtetit në ofrimin e shërbimeve miqësore, jo-diskriminuese dhe mbrojtëse ndaj këtij komuniteti.

Në tërësi të gjitha institucionet që janë garante dhe përgjegjëse për avancimin e të drejtave të komunitetit LGBT e kanë të nevojshme rritjen e kapaciteteve për këtë tematikë si dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të punës që synojnë avancimin e këtyre të drejtave bazuar në një konsultim konstruktiv me komunitetin LGBT.

PJESA 3

SITUATA POLITIKO-SOCIALE E KOMUNITETIT LGBTI

ORGANIZATAT LGBTI NË VEND

Hapat e parë të një lëvizje moderne LGBT në Shqipëri nisën në vitin 1994 me krijimin e organizatës së parë gej në historinë e Shqipërisë, “Gay Albania”. Lajmi u bë publik në të përditshmen “Koha Jonë” më 29 Mars 1995. Dy javë më pas e njëjta gazetë botoi intervistën e parë me një aktivist gej, e para e këtij lloji që prej vitit 1945 që bënte fjalë për të drejtat seksuale. Në Nëntor të 1995 Parlamenti i Shqipërisë ndryshon Kodin Penal duke dekriminalizuar “pederastinë” e cila në ato kohë përdorej si term për marrëdhëniet seksuale mes personave të të njëjtës gjini.

Më 1999 pas largimit të kryetarit të Gay Albania nga Shqipëria, krijohet organizata e dytë e komunitetit e quajtur ALGA – Albanian Gay Association. Në vitin 2000 fondacioni SOROS bën një përpjekje për të asistuar në riorganizimin e komunitetit LGBT me idenë që vetë komuniteti të krijonte një fondacion për të drejtat LGBT.

Në vitin 2003 bëhet një tjetër përpjekje nga një grup të rinjsh nga Shqipëria për të ngritur një lëvizje të re LGBT. Organizata e krijuar u quajt GISH – Grupi për Integrimin Shoqëror.

Në vitin 2006 Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut nisi përgatitjen për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Puna u finalizua në fund të vitit 2009 dhe ligji hyri në fuqi në Mars 2010.

Në Korrik 2009 Kryeministri i atëhershëm i Shqipërisë, Sali Berisha doli publikisht në mbrojtje të komunitetit LGBT dhe u prononcua pro martesave brenda gjinisë.

Në periudhën 2008-2009 u krijuan grupimet e para të mëdha në mbrojtje të komunitetit LGBT në Shqipëri të cilat më pas u kthyen në organizata: Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri dhe Aleanca kundër Diskriminimit LGBT.

Në vitet 2011-2014 dy organizata të tjera nisën angazhimin për kauzën LGBT: Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT dhe Open Mind Spectrum Albania.

Në 17 Maj 2012, Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri organizoi të parin event publik në mjedis të hapur me tematikë çështjen LGBT “Festivali i Diversitetit”. Po atë datë u zhvillua edhe Gay Ride, marshimi me biçikleta kundër homofobisë. Në 17 Maj 2014 Ambasada PINK, Shtëpia e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri dhe OMSA, organizuan të Parin Marshim të Krenarisë në Tiranë.

Në 11 Qershor 2015, do të zhvillohet Parada e Dytë e Krenarisë në Tiranë.

Organizatat LGBT që punojnë aktivisht në Shqipëri për këtë kauzë janë:



Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri
Rr. Perlat Rrexhepi, Pll "ANA", Kati VII
P.O Box 1738, Tiranë
Web: www.pinkembassy.al
Email: pinkembassy@crca.al
Tel: +35542265741 & +355672075335



Open Mind Spectrum Albania – OMSA
Rr. Mihal Grameno P. 010. Shk. 1, Ap. 6
Tiranë
Web: www.omsaalbania.com
Email omsa.albania@gmail.com
Mob: +355693953920



Aleanca kundër Diskriminimit LGBT
Rr. Mine Peza
Tiranë
Web: www.aleancalgbt.org
Email: info@aleancalgbt.org
Mob: +355692331959



Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri
Web: www.historia-ime.com
Email: kristipinderi@hotmail.com
Mob: +355684042041

KËRKESAT DHE NEVOJAT E KOMUNITETIT LGBTI

Në vitin 2010, Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri zhvilloi një konsultim me pjesëtarë të komunitetit për të parashtruar kërkesat e tyre kryesore. Këto kërkesa rezultuan në përgatitjen e një Manifesti LGBT i cili parashtroi disa nga kërkesat kryesore të komunitetit.

Ato janë si më poshtë:

1. Parandalim i diskriminimit

Diskriminimi dhe paragjykimet kundër personave LGBTI mbeten probleme kryesore me të cilat përballet komuniteti në familje, shkollë, shoqëri, vendin e punës etj. Për këtë arsye komuniteti LGBTI kërkon:

- Zbatim të plotë të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Respektim dhe Promovim të të Drejtave të Komunitetit nëpërmjet:
- Caktimit të pikave të kontaktit në nivel institucional për çështjet LGBT;
- Realizimi i fushatave ndërgjegjësuere kundër diskriminimit;
- Miratimi i politikave të brendshme për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit;
- Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta mes institucioneve dhe komunitetit.

2. Rritja e sigurisë

Mungesa e sigurisë dhe pranimi lehtësisht të të qenurit gej, lesbike, biseksual/e dhe trans nga shoqëria bëjnë që komuniteti të ndihet i pambrojtur dhe i privuar nga të drejtat, që si qytetarë të këtij vendi u takojnë me ligj. Për këtë arsye komuniteti kërkon:

- Trajnim të stafëve të institucioneve publike për tu njohur me problemet dhe nevojat e komunitetit LGBT;
- Trajnim të forcave policore për tu aftësuar në respektimin e të drejtave të komunitetit dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre;
- Vendorsja e një numri falas për raste emergjence dhe për këshillim të personave LGBT;
- Rritja e sigurisë në lagje, rrugë dhe mjetet e transportit publik.

3. Shërbime sociale dhe përkujdesje

Personat LGBT hasin vështirësi në marrjen dhe përfitimet nga shërbime sociale. Këto shërbime do të ndikojnë në ndjeshmëri në rritjen e cilësisë së jetës dhe mirëqenien e tyre. Për këtë arsye rekomandohet:

- Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale dhe shërbimeve mbështetëse për komunitetin me fokus të veçantë komunitetin transgjinnor;
- Hapja e strehëzave për komunitetin në nevojë, qendrave të këshillimit, klubet sociale etj;
- Buxhetimi me pjesëmarrje dhe në konsultim me komunitetin pranë qeverisjes lokale.

4. Strehim

Një nga problemet më të mëdha për komunitetin mbetet strehimi, që prek personat që dëbohen nga familja për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Për këtë komuniteti LGBT kërkon:

- T'i jepet përparësi politikave të strehimit për komunitetin duke promovuar strehimin e sigurtë të tyre në situata emergjente;
- Sigurimi i strehimit të përkohshëm apo të përhershëm për komunitetin transgjinnor, sidomos atë që ndodhet në Tiranë.

5. Punësim

Një problem esencial që ndikon në garantimin e mirëqenies sociale të komunitetit LGBT është papunësia. Punësimi i komunitetit forcon mirëqenien e tyre dhe të familjarëve. Për këtë arsye komuniteti rekomandon:

- Shmangien e diskriminimit në punësim duke ofruar mundësi të barabarta për komunitetin;
- Të shikohet me përparësi punësimi i komunitetit transgjinnor;
- Të nxitet dhe të mbështeten nismat e vet-punësimit të komunitetit LGBT.

PRIORITETET E AMBASADËS PINK PËR VITET 2014-2017

Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe planin e kësaj të fundit për miratimin e një plani të ri veprimi me qëllim mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri, Ambasada PINK ka prodhuar një dokument me prioritete për 4 vitet e ardhshme me synimin që ato të pasqyrohen edhe në këtë plan të ri veprimi.

Prioritetet janë si më poshtë:

1. Rritja e sigurisë, mbrojtja nga dhuna dhe garantimi i mëtejshëm i lirisë së shprehjes dhe mbledhjes:
 - a. Ngritja e njësive apo caktimi i personave përgjegjës për tematikën LGBT në të gjitha rajonet e Policisë në vend. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të këtyre njësive me organizatat LGBT; Trajtimi i ankesave dhe problemeve të qytetarëve LGBT me efektivitet duke patur parasysh motivacionin që mund të qëndrojë pas krimeve ose incidenteve;
 - b. Inkurajimi i qytetarëve LGBT për të denoncuar krime dhe incidente me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor; krijimi i një klime mikpritëse jo-diskriminuese me fushata të posaçme komunikimi (website, publikime zyrtare, reklama etj) për të ndërgjegjësuar qytetarët dhe punonjësit e policisë njëkohësisht;
 - c. Mbrojtja e personave LGBT në institucione penitenciare, për mosha të rritura dhe të mitura, me shërbime të posaçme për të garantuar mbrojtjen e tyre nga çdo formë abuzimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
 - d. Zhvillimi i trajnimeve dhe reformimi i kurrikulave të Akademisë së Policisë për një njohje të për shtatshme të tematikës LGBT dhe të sjelljes së forcave të rendit, me qytetarët LGBT dhe punonjësit LGBT;
 - e. Garantimi i sigurisë dhe zhvillimit të qetë dhe të suksesshëm të aktiviteteve publike, të tilla si Marshimet e Krenarisë; realizimi i aktiviteteve të posaçme me Policinë e Tiranës për rëndësinë dhe im paktin e këtyre aktiviteteve.
2. Fuqizimi i zbatimit të ligjit, rishikimi i legjislacionit dhe përmirësimi i performancës së zyrtarëve:
 - a. Rritja e njohurive të gjyqësorit, prokurorisë dhe organeve të rendit për njohjen, identifikimin dhe luftimin e incidenteve apo krimeve me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor dhe luftimin e tyre; Reformimi i kurrikulës në shkollat e magjistraturës dhe jurisprudencës për njohjen efektive të çështjes LGBT dhe garantimit të mosdiskriminimit në vendime gjyqësore të ardhshme;
 - b. Institucionet përgjegjëse të punojnë për të luftuar fjalimet e urrejtjes dhe format e tjera të diskriminimit kundër personave LGBT; Rishikimi i Kodit Penal mbi fjalimet e urrejtjes, dhe identifikimi i neneve për amendimet e nevojshme;
 - c. Njohja e të drejtës për ndryshimin ligjor të gjinisë dhe ndryshimi i posaçëm i të gjithë dokumentacionit identifikues të mëparshëm dhe të ri (çertifikata, patenta, diploma studimi, ID etj) të personit dhe garantimi zyrtar i të drejtës së privatësisë dhe anonimatit të qytetarëve që kanë kryer këtë proces; Krijimi i ekspertizës së posaçme psikologjike, endokrinologjike dhe operative në fushën e shëndetit transeksual;
 - d. Njohja e të drejtës për të hyrë në unione civile e personave të të njëjtit seks, dhe garantimi i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që burojnë prej tyre;
 - e. Rritja dhe fuqizimi i rolit dhe impaktit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojen nga Diskriminimi dhe zbatimit efektiv të vendimeve të Komisionerit për raste flagrante të diskriminimit; Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional për fuqizimin e rolit të këtyre institucioneve në luftën kundër diskriminimit; Rritja e njohjes së përshtatshme të Ligjit anti-diskriminim nga institucionet publike.

3. Garantimi dhe rritja e mirëqenies sociale të personave LGBT:

- a. Luftimi i diskriminimit në mjedisin e punës, përmes hartimit të guidave dhe udhëzuesve të posaçëm për mos-diskriminimin në administratën publike dhe ndëshkimit të rasteve të diskriminimit;
- b. Krijimi i shanseve të punësimit për personat transgjnorë, duke garantuar privatësinë e tyre, trajnimin dhe specializime të posaçme dhe kur kjo përshtatet me gjendjen dhe situatën e tyre; Krijimi i një manuali për personat transgjnorë ku të përfshihen të gjitha fushat e jetës me rëndësi jetike për integrimin e tyre në shoqëri;
- c. Marrja e masave anti-diskriminuese në fushën e strehimit, në veçanti në lidhje me dëbimet diskriminuese nga shtëpia sidomos të miturve dhe të rinjve LGBT nga familjarët e tyre. Shërbimet sociale të krijojnë një praktikë të posaçme mbi këtë problematikë.

4. Garantimi i të drejtës së arsimit dhe mbrojtja nga bulizmi homofobik dhe transfobik në shkollë:

- a. Krijimi i programeve të posaçme edukative dhe praktikave të mira të edukimit me stafet pedagogjike për luftimin dhe ndalimin e diskriminimit, veçimit, trajtimit të diferencuar dhe negativ të nxënësve apo edhe mësuesve që mund të jenë apo të perceptohen nga të tjerët si LGBT; Krijimi i hapësirave të posaçme në shkollë për rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin për tematikën LGBT, në kuadër të të drejtave të njeriut, mbrojtjes nga bulizmi dhe dhuna;
- b. Rritja dhe përmirësimi i informacionit për tematikën LGBT në kurrikulat shkollore dhe universitare; Rishikimi me prioritet i kurrikulave të Pedagogjisë për çështjen LGBT;
- c. Krijimi i politikave të posaçme anti-diskriminim nga Ministria e Arsimit për të gjitha rastet e diskriminimit përfshi këtu orientimin seksual dhe identitetin gjinor; Krijimi i një rrjeti mbështetës/këshillues për prindërit dhe familjarët e personave LGBT.

5. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve mjekësore ndaj personave LGBT:

- a. Identifikimi i nevojave të posaçme shëndetësore të personave LGBT me fokus çështje si vetvrasja, sondazhet dhe studimet mbi shëndetin e popullatës, kurrikulat mjekësore, infeksionet seksuale transmetueshme (IST) tek minoritetet seksuale, kurset dhe materialet trajnuese, monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së shërbimit të kujdesit shëndetësor;
- b. Krijimi dhe ngritja e shërbimit të posaçëm për ndryshimin fizik të gjinisë duke përfshirë ekspertizën psikologjike, endokrinologjike dhe operative në fushën e kujdesit të shëndetit transeksual;
- c. Ndalimi i caktimit të gjinisë së detyruar për personat interseks dhe askush të mos bëhet subjekt i procedurave të ricaktimit të gjinisë pa miratimin e vetë personit;

6. Njohja e të drejtës për të jetuar në familje dhe unione civile të lirë nga diskriminimi dhe ligje diskriminuese:

- a. Njohja e partneritetit të çiftëve jo-heteroseksuale dhe bashkësisë civile; Ofrimi dhe garantimi i barazisë përpara ligjit të çiftëve jo-heteroseksuale me ato heteroseksuale; Legjislacioni të bëhet jo-diskriminues për çiftet jo-heteroseksuale në të gjitha fushat;
- b. Mbrojtja e prindërve LGBT nga trajtimi jo i barabartë ose e vendimeve diskriminuese në raste divorci;

7. Integrimi i çështjes LGBT në politikat zyrtare dhe dokumentat strategjike kombëtare dhe lokale, kur kjo është e përshtatshme:

- a. Ndërtimi i një rrjeti kombëtar LGBT ku të përfshihen administrata qendrore dhe lokale, institucionet e të drejtave të njeriut dhe organizatat LGBT;
- b. Ndërtimi i një politike / praktike kombëtare për ndalimin e shprehjes së çdo forme urrejtje apo diskriminimi nga zyrtarë të administratës publike dhe sektorët e shërbimeve për qytetarët;

- c. Gjithë sektorët e administratës publike, atëherë kur është e përshtatshme, të nisin bashkëpunimin reciprok dhe me organizatat LGBT;
- d. Zhvillimi i një seminari ndërkombëtar me qëllim prezantimin e vizionit të vendit për çështjen LGBT dhe impenjimet aktuale;
- e. Mbështetja dhe promovimi i artit dhe kulturës me tematikë LGBT;
- f. Rritja e angazhimit për zhvillimin e turizmit me tematikë LGBT, përfshi këtu ofrimin e informacionit dhe shërbimeve për turistë nga ky komunitet.

8. Rritja e angazhimit të shtetit shqiptar me tematikën LGBT në nivel rajonal, evropian dhe global:

- a. Promovimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit rajonal në avancimin e të drejtave LGBT dhe luftën kundër diskriminimit; Ofrimi dhe krijimi i hapësirave për zhvillim aktiviteteve rajonale dhe globale mbi çështjen LGBT;
- b. Nënshkrimi i dokumentave, marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare që promovojnë mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave LGBT;
- c. Lobimi dhe komunikimi pro-aktiv me vende të cilat janë shumë më të avancuara me çështjet LGBT dhe rritja e ndikimit pozitiv për vende që kanë praktika negative kundër komunitetit LGBT, veçanërisht në rajon.

9. Përgatitja e një plani komunikimi bazuar në objektivat dhe aktivitetet e mësipërme:

- a. Përgatitja e një plani komunikimi / ndërgjegjësimi online dhe offline.

STATISTIKA DHE PERCEPTIME

Aktualisht Shqipëria nuk disponon një numër të madh studimesh mbi tematikën LGBT. Vitet e para të angazhimit të organizatave LGBT kanë shërbyer për rritjen e ndërgjegjësimit si dhe përfshirjen e institucioneve publike, organizatave dhe gjithë grupeve të tjera të interesit në këtë çështje. Për këtë arsye së fundmi janë prodhuar edhe të parat rezultate nga perceptimet mbi këtë tematikë.


Më poshtë janë një listë e studimeve dhe perceptimeve:

Rinia Shqiptare: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!

Paragjykimet mes të rinjve për personat homoseksualë janë shumë të forta. 50% e të rinjve shqiptarë nuk do ta mirëprisnin fqinjësinë me një çift homoseksual dhe do të ndiheshin keq ose shumë keq nga një gjë e tillë. Meshkujt kanë një përqindje më të lartë paragjykimi me mbi 67% krahasuar me 46% të femrave ndërkohë që homofobia është e shtrirë në çdo kategori. Shifrat më të larta të këtij paragjykimi vërehen në fshatra ku 58% e të rinjve atje e shohin si diçka shumë të keqe këtë lloj fqinjësie përkundrajt 45% e të rinjve në Tiranë. Në aspektin gjinor vërehet se femrat përbëjnë pjesën më të madhe të të rinjve të painteresuar nga kjo fqinjësi, pra shprehen se do të tregoheshin indiferentë para një situatë të tillë. Nga ana tjetër vetëm 8.5% e të rinjve do të mirëprisnin diçka të tillë ku sërish femrat shfaqen më pak paragjyquese me 12%.

Si do të ndiheshit nëse në pallatin/pranë shtëpisë tuaj do të vinte të banonte një çift homoseksualësh?

Meshkuj vs. Femra



Sipas të njëjtit studim, këto janë disa nga komentet e të rinjve kur pyeten për personat homoseksualë:

TË RINJTË SHQIPTARË SI HOMOFOBË

Të rinjtë shqiptarë ushqejnë paragjykime të forta ndaj homoseksualëve çka ndjehet edhe gjatë bisedave me ta. Të pyetur sesi do reagonin nëse do të kishin fqinj njerëz të tillë, të rinjtë e qytetit përgjigjen me nota tallëse dhe përcmuese:

-Evisa: "S'do kisha lidhje fare me ta."

-Alketi: "Unë nuk i duroj dot."

-Romeo: "Sa shkojnë me njëri tjetrin."

-Dafina: "E vetmja gjë që do të thoja në një rast të tillë është: Bo bo sa gjynah që janë!"

-Sajmiri: "Unë s'do reagoja, por thjesht fakti që kam pranë si fqinj njerëz të tillë do ma shpifte."

-Rudina: "Po ti pyesësh shqiptarët se çfarë mendojnë për këtë gjë, përpara kamerave ata të përgjigjen se nuk janë racistë dhe për ata homoseksualët kanë jetën e tyre, por në fakt i shohin si njerëz me probleme psikike dhe nuk i durojnë dot këto lidhje brenda seksit."


Për Redionin, 25 vjeç, është diçka e mirë që reagimi i njerëzve ndaj homoseksualëve mbetet vetëm në nivelin e paragjykimit: "Ne jemi ca racistë në këtë drejtim e nuk mund të themi se s'do ndiheshim të shqetësuar. Është e vërtetë që ai çifti i homoseksualëve do shikohej shtrembër, por të dhunshëm nuk jemi."

Të rinjtë meshkuj nga zonat rurale janë më të ashpër në reagimet e tyre ndaj këtyre rasteve.

- Olsi shprehet: "i urrej në maksimum", ndërsa Arbëri thotë: "nuk do i flisja dhe nuk do të doja kurrë ti kisha pranë si fqinj."
- Kurse Eri pohon: "po të më vinin afër si komshinj do tu thoja: na merr shtëpinë time se po iki unë që prej këtu."
- Mes tyre vërehen edhe reagime pak më të buta sikurse Erlindi që pranon: "Nuk mund të them se çfarë do të bëja pasi nuk më ka rastisur ndonjëherë ti kem fqinj. Të them të drejtën nuk është se më pëlqejnë shumë, por kanë të drejtën e tyre."

Të rinjtë meshkuj nga zonat rurale janë më të ashpër në reagimet e tyre ndaj këtyre rasteve.

- Olsi shprehet: “i urrej në maksimum”, ndërsa Arbëri thotë: “nuk do i flisja dhe nuk do të doja kurrë ti kisha pranë si fqinj.”
- Kurse Eri pohon: “po të më vinin afër si komshinj do tu thoja: na merr shtëpinë time se po iki unë që prej këtu.”
- Mes tyre vërehen edhe reagime pak më të buta sikurse Erlindi që pranon: “Nuk mund të them se çfarë do të bëja pasi nuk më ka rastisur ndonjëherë ti kem fqinj. Të them të drejtën nuk është se më pëlqejnë shumë, por kanë të drejtën e tyre.”



Gjithsesi në këtë drejtim vajzat shfaqen shumë më tolerante sesa djemtë, madje edhe në fshat. Ato thonë se nuk do ti bënte përshtypje një fqinjësi e tillë.

- Alisia e përmbledh me shprehjen e thjeshtë: “Ul kokën e vazhdo punën tënde, ç’të keqe ka këtu,” ndërsa Kuneja thotë: “problem do të ishte nëse të ngacmojnë apo të bien më qafë, por në të kundërt shiko punën tënde dhe ska problem.”

Është interesante që në këtë pjesë të bisedës, asnjë nga të rinjtë nuk përdor termin “homofobi” për t’ju referuar këtij lloj diskriminimi, por të gjithë përdorin shpesh fjalët “racizëm” ose “racistë.”

HULUMTIMI SOCIAL EVROPIAN

Hulumtimi Social Evropian është i pari kërkim i cili krahason perceptimet e publikut shqiptar në mënyrë krahasimore me ato të Bashkimit Evropian. Nga vendet e Ballkanit Perëndimor në këtë studim morën pjesë vetëm Kroacia (atëherë kandidat për tu bërë pjesë e BE) dhe Shqipëria. Ndër të tjera Hulumtimi Social pyeti të anketuarit edhe mbi personat LGB me pohimin: “Gejt dhe lesbiket nuk duhet të jenë të lirë ta jetojnë jetën ashtu si duan”. 53% e të anketuarve shqiptarë e miratuan këtë pohim. Tabela e mëposhtme tregon se praktikisht nga të gjitha vendet e anketuara, Shqipëria është vendi më homofob në Evropë:

RAPORTET E SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Që prej vitit 2011 Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri prodhon dhe publikon raporte të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Të dhënat e këtij raporti mblidhen përmes dëshmimeve të personave LGBTI që kontaktojnë drejtpërdrejt Ambasadën PINK, raportimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit, dhe publikimet mediatike.

Për ilustrim, më poshtë gjeni katër raste të shkëputura nga çdo vit:

Viti 2011 – Rasti i një çifti gej në Tiranë

Një çift gej në Tiranë raportoi në Ambasadën PINK dhunën dhe diskriminimin që kishin pësuar nga policia dhe të afërmit. Pas një incidenti familjar lidhur me faktin që ishin gej dhe që bashkëjetojnë, në rastin që njëri nga vëllezërit e djemve kishte agresuar dhe kërcënuar t'i vriste, çifti kishte shkuar në Polici për denoncim. Sapo shpjeguan situatën ata ishin pritur me të qeshura dhe ofendime nga oficerët e Policisë. Në vend që të merrnin denoncimin dhe të merrnin masat e duhura, Policia e mbajti çiftin dhe për 10 orë të tjera, duke i trajtuar si fajtorë të incidentit. Gjatë gjithë kohës që ishin në rajon janë tallur dhe ofenduar për shkak të orientimit të tyre seksual. Pas marrjes së incidentit të tyre Ambasada PINK i dërgoi një letër ankese Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe asistoi çiftin në përgatitjen e dokumentacionit. Ambasada PINK negocioni për ndihmë ligjore falas, për rastin, nga një studio ligjore në Tiranë.

Viti 2012 – Rasti “Perla”

Më datë 11.04.2012, paraqitet pranë PINK, Perla (pjestare e komunitetit transgjinnor), e cila raporton dhunën psikologjike, fizike dhe izolimin që ka pësuar në mënyrë të vazhdueshme nga i vëllai i saj 40 vjeçar për gati 5 muaj, që nga koha kur ai ka marr vesh për identitetin e tij gjinnor.

Ndërkohë rasti më i fundit i dhunës ka ndodhur vetëm një natë më parë, rreth orës 19.00, kur i vëllai pas një zënke e ka qëlluar me pëllëmbë dhe e ka nxjerrë në oborr me gjithë rrobat e tij, duke i thënë se nëse largohet nga shtëpia nuk kthehet më në të. Megjithë kërcënimin e të vëllait Perla ka lënë shtëpinë dhe e ka kaluar natën tek një shoqe e saj.

Ajo tregon se në momentin e zënkës nuk ka pasur as reagimin as përkrahjen e 8 anëtarëve të tjerë të familjes dhe se ndihet e izoluar nga shoqëria dhe të afërmit.

Ambasada Pink pas bisedës që pati me të e këshilloi që të rikthehet në familje dhe të mundohet të flasë me qetësi me vëllain ku ti shpjegojë se është në moshë madhore dhe ka përgjegjësi të plotë për veten, ta bindë atë të ndryshojë mënyrën e të sjellurit dhe të komunikimit.

Gjithashtu e këshilluam që të flasë me anëtarët e tjerë të familjes që e mbështesin ose janë më të afërt me të si nëna apo vëllai më i vogël jo vetëm për ti pasur aleatë por edhe për të folur me vëllain e madh dhe për ta bindur atë të ndryshojë sjellje dhe qëndrim ndaj saj.

U këshillua që në rast të ndonjë zënke tjetër të na kontaktonte. Perla u kontaktua edhe një ditë më pas nga PE dhe na komunikoi se ishte kthyer në shtëpi dhe gjithçka kishte shkuar mirë, situata familjare i është kthyer normalitetit dhe qetësisë.

Gjithsesi ky rast dhe te tjera, mbase të paraportuara formalisht por të njohura përmes bisedave gjatë aktiviteteve, tregojnë se komuniteti LGBT në vend vazhdon të jetojë nën presionin e dhunës e vazhdueshme fizike dhe emocionale të familjarëve të tyre për mohimin dhe fshehjen e identitetit gjinnor apo orientimit të tyre seksual.

Viti 2013 – Rasti “Spahia”

Në puntatën e 19-të, të emisionit “Debati në Channel One” të datës 21.03.2013, transmetuar në televizionin “Channel One”, me temë “Pedofilia në Shqipëri”, u diskutua lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, duke marrë shkas nga ngjarja e ndodhur në Qytetin e Tiranës, ku një fëmijë është zhdukur dhe një tjetër është dhunuar seksualisht. Në këtë emision ishin të ftuar gazetarë, analistë dhe politikanë. Ndër të ftuarit në këtë emision ishte dhe z. Ekrem Spahia, politikan, aktualisht Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe Zv/Ministër i Mbrojtjes.

Në një analizë që z. Spahia i bën shkaqeve që kanë çuar në një situatë të tillë, shprehet ndër të tjera për “ato e ngrejne zërin duke ndihmuar edhe media, për një kategori që kërkojnë të na e imponojnë si një vlerë për shoqërinë shqiptare, siç janë homosensualët dhe merren më shumë me ata, dhe nuk merren pikërisht me fëmijët që ata janë krejtësisht pasojat e kësaj lirie që kërkojmë” ose “OJQ-të, po pikërisht ato stimulojnë atë kategori njerëzish që çojnë në këto krime monstruoze dhe prandaj ne jemi kategorikisht kundër tyre,ato kanë një tendencë që të bëjnë sa më shumë, më falni se ne na vjen zor qoftë me e përmend...., jo më ta aplikojmë, të bëjmë sa më shumë homoseksualë. Dhe atëherë kjo është tendenca e tyre ti mashtrojnë fëmijët me pare, se kanë para ato.....Pra gjëja më pavlerë në shoqërinë njerëzore, kërkojnë të na e imponojnë, na kundërvihen se është një civilizim dhe është njeri modern ai që qënka homoseksual. Dhe kujt tu drejtohen këta fëmijë, te ata njerëz që duan të shtojnë radhët e tyre dhe të na i nxjerrin nëpër bulevardet e Tiranës”

Pas këtij transmetimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: “Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, nenin 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara, Komisioneri me urdherin nr. 37 , datë 05.04.2013, filloi procedimin administrativ kundër z. Ekrem Spahia, i ftuar në këtë emision.

Pas procedimit KMD vendosi se Deklaratat e z. Ekrem Spahia janë diskriminim i drejtpërdrejtë pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe çenojnë të drejtën për siguri dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual; Detyrimin e z. Ekrem Spahia, të kërkojë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit për këtë vendim dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual; Detyrohet z. Ekrem Spahia, që brenda 30 ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi dhe moszbatimin i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.

Viti 2014 - Rasti “peticioni i intelektualëve ‘familje e shëndoshë, atdhe i shëndoshë’”

Ambasada PINK, u njoh me publikimin e një peticioni të nënshkruar nga 57 të ashtu-quajtur intelektualë, nën titullin “Familje e shëndoshë, atdhe i shëndoshë”, në faqen 7 të Gazetës Panorama, të datës 21 Maj 2014 dhe në gazetën Tema online të po të njëjtës datë.

Ky peticion, nxiste publikisht urrejtjen kundër personave me orientim seksual dhe identitet gjinor LGBT, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, menjëherë pas organizimit të Paradës së parë gay në Shqipëri.

Po atë ditë PE reagon përmes një Deklarate Publike dërguar në të gjitha mediat e vendit dhe institucionet publike dhe jo-publike të të drejtave të njeriut në vend si një notë proteste ndaj peticionit i cili vetëm nxiste urrejtjen dhe homofobinë ndaj çdo personi LGBT dhe mbështetësve të tyre në Shqipëri. PE gjithashtu bën një kërkesë pranë institucionit të Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku i kërkon fillimin e një hetimi ex-officio për këtë rast.

Ndërkohë një ditë më pas, më datë 22 Maj 2014, po në gazetën panorama, Dr. Agron Gjekmarkaj, emri i të cilit ishte publikuar zyrtarisht si nënshkrues i peticionit prej 57 personash, deklaroi publikisht se ai nuk ishte nënshkrues i tij.

Po në datë 22 Maj 2014, në versionin on-line të gazetës Panorama (www.panorama.com.al) tek artikulli i botuar në datë 21 Maj në lidhje me peticionin, nga versioni original i 57 intelektualëve nënshkrues, hiqen pa asnjë shpjegim dy emra: Agron Gjekmarkaj dhe Alfred Lela (zv.kryeredaktor i Gazetës MAPO).

Pas kësaj, PE më datë 26 Maj 2014 dërgon një kërkesë zyrtare drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë, për fillimin e hetimeve për mashtrim dhe nxitje urrejtje për autorët e peticionit “Familje e Shëndoshë, atdhe i shëndoshë”. Për dijeni kjo kërkesë j’u dërgua edhe institucioneve publike dhe të pavarura në vend për të drejtat e njeriut si edhe tek agjensitë dhe ambasadat e huaja në vend.

KRIMET DHE FJALIMET E URREJTJES

Ndërkohë që Shqipëria ka vetëm një rast të njohur krimi urrejtje i cili rezultoi me vdekjen e viktimës, fjalimet e urrejtjes në mediat tradicionale, elektronike dhe sociale janë të shpeshta dhe të rëndomta.

Fjalime urrejtje janë gjithë ato fjalime të cilat ofendojnë, kërcënojnë apo fyejnë grupe individësh bazuar në racën, ngjyrën, besimin, origjinën, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar etj. Diskutimi mbi fjalimet e urrejtjes është i vështirë sepse ndalimi i këtyre fjalimeve rrezikon të limitojë të drejtën e një individi për tu shprehur i/e lirë. Por ndërkohë sa herë që ushtrohen fjalime urrejtje lind një konflikti i cili pyet se çfarë është më e rëndësishme – mbrojtja e interesave të komunitetit apo mbrojtja e të drejtës së individit për tu shprehur? Në kësi rastesh duhet gjetur një balancë e cila mbron të drejtat civile të të gjithë qytetarëve pa limituar gjithsesi lirinë e shprehjes së individit.

Në Shqipëri fjalimet e urrejtjes apo diskriminuese janë të shpeshta. Më poshtë janë disa ilustrime nga fjalime të urrejtjes të personazheve publikë apo komente tipike të publikut në mediat sociale:

Viti 2012 – Rasti “Ekrem Spahia”

Rasti më flagrant i diskriminimit dhe shprehjes së homofobisë ndaj komunitetit LGBT në vend gjatë këtij muaji, ishte deklarata e zv. Ministrit të Mbrojtjes z. Ekrem Spahia, e datës 23 Mars 2012 në gazetën Shqiptare dhe disa të përditshme të tjera, ku thuhej se komuniteti LGBT nëse do të dilte në manifestime do të “kapej në hu”, në të cilën ka përdor hapur gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e homofobisë.

PE reagoi menjëherë përmes një deklarate dërguar kryeministrit të vendit ku i kërkohej të merreshin masa të menjëhershme distancimi ndaj qëndrimit të zv.ministrit të qeverisë së tij.

Menjëherë pas deklaratës së PE, kryeministri në një koment të tij në mbledhjen e grupit të PD, ka thënë se deklaratat e zv/ministrit të Mbrojtjes, Ekrem Spahiu, janë të papranueshme dhe nuk tregojnë aspak qëndrimin mbretëror.

Ndërkohë PE ka reaguar gjithashtu përmes debateve në median e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu me iniciativën e PE u organizua edhe tryeza e rumbullakët e shoqërisë civile në bashkëpunim me dy grupimet e tjera LGBT në vend, dhe me pjesëmarrjen e organizatave dhe institucioneve të të drejtave të njeriut, nga e cila dolën një sërë rekomandimesh që duhet të zbatohen për respektimin e komunitetit LGBT në vend.

Komente në internet:

Komenti i një lexuesi ndaj propozimit të Avokatit të Popullit për të njohur bashkëjetësën midis çifteve të të njëjtit seks:

vertetuesi Shkolla e tepert ose te larteson ose te shkallon. Ky eshte cmendur. A ka familje ky? I propozoj qe pikesepari ta zbatoje kete martese ne familjen dhe fisin e tij. Valle a i ke zgjidh poblemet e shqiptareve dhe te ka ngel te zgjidhesh ushkuret e ketyre te degjeneruarve?

d d debil i ndyre per kesoj lajmesh ka nevojë kjo shoqëri tu martofte ishalla femija jot me te njenjtin seks avokat leshi ketu ka probleme me kile.

Al Cfare eshte ky mer, ky vec me jevgj legena (se ka dhe nga ato qe jane integru dhe per tu pase zili) dhe me keta mirret, pse mer pak shtresa ne nevojë ka vendi te cilet kane integritet dhe nuk e ulin veten per te marre lemoshe por i bejne balle jetes ne rrethana te paimagjinueshme

AKTIVITETE AVOKUESE DHE LOBUESE PËR NJOHJEN E KOMUNITETIT LGBT

Në kuadër të mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të komunitetit LGBT, në këto 6 vite aktivitet, Ambasadë PINK zbatoi një plan strategjik i cili synonte të bënte të mundur që në shoqërinë shqiptare në zhvillim, pozicioni, të drejtat dhe nevojat e komunitetit të personave lesbike, gej, biseksualë e transgjinerë të respektohen plotësisht dhe nevojat dhe shqetësimet e tyre të adresohen në mënyrën e duhur.

Në këto vite të para veprimi i PINK u orientua në dy drejtime kryesore:

1. Avokaci dhe lobim për të garantuar respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT – përmes fushatave informuese dhe edukuese, monitorimit të rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT dhe reagimi ndaj kujtdo që i cënon apo vë në rrezik këto të drejta, ndikimit mbi qeverinë dhe politikë-bërjen për të ndërtuar mekanizma efektivë në favour të komunitetit LGBT.

2. Krijimit të kushteve të favorshme për të lehtësuar dukshmërinë dhe mobilizimin e komunitetit LGBT – përmes organizimit të aktiviteteve sociale, diskutimeve në grup, ngritjes së grupeve “mentor” dhe “peer support” dhe aktiviteteve që fuqizojnë këtë komunitet për t’u bërë zëdhënës dhe mbrojtës të të drejtave të tyre.

Në këtë kuadër PINK punoi me ngritjen fizike të një zyre dhe qendër pritje për komunitetin LGBT, krijimin e një rrjeti mbështetës institucionesh dhe organizatash “Miq të PINK”, rritjen e vizibilitetit të kauzës LGBT elektronikisht dhe publikime të ndryshme si revista “Divers” dhe njoftime E-news, publikime periodike në faqen www.pinkembassy.al etj.

Se dyti PINK punoi për rritjen e mbështetjes së kauzës LGBT nga komuniteti ndërkombëtar dhe në rritjen e besimit të komunitetit LGBT ndaj tematikës LGBT. Për këtë institucioni punoi për të siguruar mbështetjen e individëve pjesëtarë të komunitetit LGBT, fushata ndërgjegjësuere dhe informuese për të siguruar mbështetjen e institucioneve kombëtare, komunitetit ndërkombëtar, organizatat e të drejtave të njeriut etj.

Së treti PINK punoi për përmirësimin e qëndrimit dhe sjelljes së shoqërisë dhe qeverisë shqiptare në drejtim të respektimit të të drejtave të personave LGBT. Kjo u arrit përmes monitorimit, identifikimit, dokumentimit dhe reagimit ndaj rasteve të dhunimit të të drejtave të komunitetit LGBT, avokaci dhe lobim për të garantuar respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT, adresime publike mbi pozitën, të drejtat, nevojat dhe shqetësimet e komunitetit LGBT etj.

Së katërti, krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që mundëson shoqërizimin, organizimin, forcimin dhe rritjen e kapaciteteve të komunitetit LGBT. Kjo u arrit përmes krijimit të një rrjeti psikologësh dhe mbështetësish ndaj pjesëtarëve të komunitetit, krijimi i një grupi mbështetës, evente shoqërizuese dhe informuese të komunitetit LGBT dhe evente më të gjera me pjesëtarë të komunitetit LGBT.

PRIDE DHE MANIFESTIME TË TJERA

Viti 2012: Shqipëri, Komuniteti LGBT bën histori me Festivalin e Diversitetit!

Festivali i Diversitetit theu tabutë mbi komunitetin LGBT në Shqipëri. Shoqëria civile, diplomatët e huaj dhe qindra qytetarë bashkohen me Ambasadën PINK në qendër të Tiranës, për ti thënë jo homofobisë!

Tiranë 17 Maj 2012 - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë, Shqipëria organizoi për herë të parë një aktivitet masiv publik në një nga sheshet kryesore të Tiranës, të quajtur “Festivali i Diversitetit”, nën moton: “Bëj Lëvizjen e Duhur. Ngri Flamurin”.

Nën organizimin e Ambasadës PINK/LGBT Pro Shqipëri dhe pjesëmarrjen e institucioneve publike, atyre në mbrojtje të të drejtave të njeriut, organizatave të shoqërisë civile dhe misioneve diplomatike në vend, “Festivali i Diversitetit” theu tabutë mbi komunitetin LGBT dhe organizimeve të tyre publike.

Aktivitetet e ditës nisën herët në mëngjes me konferencën për shtyp, gjatë të cilës mediave iu prezantua koncepti dhe qëllimet e Festivalit. Përpara gazetarëve folën: Ambasadori i Parë i Ambasadës PINK, z. Altin Hazizaj, Zv. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, znj. Filloreta Kodra dhe z. Henk van den Dool, Ambasador i Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.

Festivali u çel zyrtarisht në orën 10:00 pranë sheshit “Vëllezërit Frashëri”. Por përpara hapjes së festivalit, një mini-paradë e paparashikuar u organizua rastësisht, kur përfaqësuesve të Ambasadës Pink, Qeverisë Shqiptare, Ambasadës Hollandeze, iu bashkua edhe Avokati i Popullit dhe dhjetra qytetarë, të cilët ecën përgjatë Bulevardit Dëshmorët e Kombit drejt Sheshit “Vëllezërit Frashëri”, për tu bashkuar me miq e kolegë që prisnin në shesh.

I dekoruar me flamujt shumëngjyrësh dhe nën tingujt e muzikës, në shesh ndodheshin disa dhjetra organizata të shoqërisë civile dhe institucioneve të tilla si Ministria e Punës, Avokati i Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit përkrah shumë qytetarëve, të rinjve, studentëve dhe vajzave e djemve të komunitetit LGBT.

Z. Altin Hazizaj, Ambasador i Parë i Ambasadës Pink, falenderoi publikisht të gjithë ata persona nga fusha e medias, politikës, akademisë, shoqërisë civile etj, të cilët me aktivitetin e tyre kanë kontribuar për avancimin e kauzës LGBT dhe diskutimin e saj në forume të gjëra, duke dalë kështu përballë dhe kundër paragjykit. Falenderime të veçanta iu bënë edhe gjithë organizatave që iu bashkuan ftesës për të marrë pjesë në Festival. Fjalime përshendetëse në mbështetje të kauzës LGBT u bënë nga Zv. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Znj. Filloreta Kodra, Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, Z. Henk van den Dool, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara, Z. Aleksandër Arvizu, Z. Clive Rumbold, Shef i Seksionit Politik pranë Zyrës së Bashkimit European, Z. Igli Totozani, Avokat i Popullit dhe Znj. Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen kundër Diskriminimit.

Një nga momentet më të bukura të kësaj pjese të parë ishte lëshimi i balonave që formonin Flamurin LGBT, të cilat fluturuan në qiellin gri të Tiranës.

Pas këtij momenti, Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri dhe Zyra e Komisioneres për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, promovuan broshurën më të re informuese/edukuese “Të drejtat e mia para komisionerit” i cili do i shpërndahet komunitetit LGBT dhe gjithë qytetarëve për tu informuar mbi Zyrën e Komisioneres dhe për mbrojtjen që ofrohet nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Festivali vazhdoi me çeljen e Ekspozitës së Fotografisë “Qyteti i Ngjyrave” pranë EU Info Centre në Tiranë e përgatitur dhe kuruar nga vullnetarët dhe të rinjtë e Ambasadës PINK. Kjo ekspozitë u mirëprit nga z. Clive Rumbold prej Bashkimit Evropian, Znj. Eunice Heudt nga COC Hollandë dhe znj. Belioza Çoku, Ambasadore e Dytë e Ambasadës PINK/LGBT Pro.

Ekspozita përmban foto nga mjedise urbane dhe private, shumëngjyrëshe dhe të larmishme dhe që ngjasojnë në një mënyrë apo tjetër me ngjyrat e flamurit të ylberit. Z. Hoedt u shpreh se “pavarësisht se kjo ekspozitë nuk përmban njerëz, këto foto tregojnë se ne jemi këtu, mes jush...”. Ekspozita do të jetë e hapur deri më 31 Maj 2012.

Më tej, Festivali u përmyll me shfaqjen e dy filmave të shkurtër shqiptarë, pranë Akademisë “Marubi” me tematika LGBT të realizuara nga artistët e rinj Artan Karoli dhe Soena Lame. Filmat flisnin për çështje të tilla si bulizmi në shkollë dhe procesi coming out tek të afërmit.

Për Ambasadën PINK/LGBT Pro Shqipëri, ky Festival përbën kulmin e përpjekjeve për të thyer njëherë e përgjithmonë tabutë izoluese, përçmuese dhe errësuese të shoqërisë sonë, të cilat deri ditën e djeshme nuk kishin patur mundësi të njiheshin me një aktivitet të përmasave të tilla sociale dhe politike, në një shesh të hapur, ku përcilleshin mesazhe të singërta tolerance, pranimi dhe dashurie, kundër homofobisë, transfobisë, urrejtjes, përçarjes dhe denigrimit.

Për shoqërinë shqiptare, ky event përbën një revolucion të vogël social, një dritare të re prej nga shoqëria shqiptare, edhe pse ngadalë, do duhet të shohë botën. Ky Festival synonte të tregonte dhe ndante me shoqërinë shqiptare optikën njerëzore, të një komuniteti të veçuar, izoluar dhe urryer pa të drejtë, të një komuniteti me plot njerëz të talentuar, që vijnë nga çdo fushë e jetës, jetojnë në çdo cep të vendit tonë të cilët edhe pse në mënyrë predominuese të padukshëm, japin kontribut për zhvillimin dhe avancimin e shoqërisë sonë.

Viti 2014 – Mbahet Marshimi i Parë i Krenarisë në Tiranë

17 Maj 2014 - Kjo Ditë Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë ishte historike për Shqipërinë dhe qytetarët LGBT. Vendi ishte sot dëshmitar i marshimit të parë të krenarisë, me aktivistë dhe mbështetës që ecën me flamurin gjigand të paqes në qendër të kryeqytetit.

Pavarësisht shiut të rrëmbyeshëm, tingujt e daulleve, bilbilat dhe valëvitja e flamurit madhështor ishin një emocion i veçantë për të gjithë pjesëmarrësit.

Java e Diversitetit, organizuar nga Ambasada PINK, Shtëpia e të Drejtave të Njeriut dhe Open Mind Spectrum Albania ka qenë e mbushur me aktivitete të shumta kulturore dhe sociale që kishin si objektiv ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi këtë tematikë. Por gjithçka kulmoi sot me pjesëmarrjen e shumë njerëzve në marshimin e parë në rrugët e kryeqytetit.

“Thuaj Po Dashurisë” ka qenë slogani i këtij Pride. Të përfshirë në debatin e zhurmshëm, emocional dhe shumë të gjatë të të drejtave të njeriut, mjaft njerëz harrojnë, se beteja për barazi, është thjesht për të garantuar të drejtën e dy njerëzve, jo vetëm për të afirmuar orientimin apo identitetin e tyre, por për ta shprehur atë përmes ndjenjës më të shenjtë njerëzore, asaj që na bashkon të gjithëve, dashurisë.

Në Panairin e Diversitetit, si dhe në aktivitetet e tjera kundër homofobisë që u zhvilluan në qytet morën pjesë shumë qytetarë të cilët injoruan shiun e rrëmbyeshëm, orët e pushimit të fundjavës dhe u bashkuan në mbështetje të të drejtës për të dashuruar dhe për tu pranuar.

Ambasada PINK, HRHA dhe OMSA falenderojnë të gjithë personat që morën pjesë në Pride-in e parë në vend, gjithë institucionet, organizatat dhe qytetarët e thjeshtë, ashtu si edhe punonjësit e Policisë, gazetarët dhe operatorët që ndoqën aktivitetet nga afër.

Ne sot i thamë Po dashurisë, asaj dashurie që ende shumë njerëz nuk ia thonë dot emrin. Por, ajo ka qenë, është dhe do vazhdojë të jetë aty, për të rrezatuar edhe në ditë me shi.

PINK, HRHA & OMSA



PJESA 1

Identifikimi i Shërbimeve të Ofruara

Prezantim nga Institucioni

Secili pjesëmarrës në trajnim bën një prezantim të drejtorisë apo departamentit në të cilin punon, dhe jep shembuj konkret të punës që mund të ketë patur me individë nga grupe vulnerabël në shoqëri, qofshin këto LGBT por edhe grupe të tjera.

Raste studimore:

RASTI 1: Një person transgjinnor vjen pranë Zyrës suaj.

Një person i komunitetit transgjinnor vjen pranë zyrës suaj. Ai ka pamjen e një mashkulli dhe ID e tij e vërteton këtë gjë, por ndërkohë ka sjellje femërore, ka flokë të gjata, dhe është veshur me fund dhe ka një çantë gruaje dhe i prezantohet specialistit me emrin Mira.

Mira thotë se është e papunë, në gjendje shumë të vështirë ekonomike, pa mbështetje sociale. Po ashtu ajo jeton në shtëpi të shokëve dhe shoqeve dhe është e pastrehë. Ajo ka përfunduar vetëm 8 klasë shkollë dhe nuk ka një profesion specifik.

Mira i thotë ekspertës që takon se nuk dëshiron të jetojë më në rrugë dhe se dëshiron të ketë një punë si gjithë të tjerët.

Çfarë hapash konkretë duhet të marrë ekspertja për të trajtuar këtë rast?

RASTI 2: Djalë gej i dhunuar nga prindërit dhe dëbuar nga familja:

Beni është 17 vjeç. Ai ka shenja dhune në fytyrë dhe duar. Duket i pagjumë dhe në gjendje shumë të keqe fizike. Ai paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social. Në takim me punonjës të social, Beni sqaron se është dëbuar nga shtëpia vetëm pak ditë më parë. Ai tregon se gjithë këto ditë ka fjetur në rrugë, se nuk shkon më në shkollë, dhe se nuk di ku të shkojë. Ai tregon se babai e ka rrahur pasi ka marrë vesh që Beni është gej dhe e ka dëbuar nga shtëpia me kërcënimin se do e vrasë. Beni kërkon ndihmë dhe është shumë konfuz se ku duhet të kërkojë ndihmë dhe për çfarë duhet të kërkojë ndihmë.

Mënyra praktike për të krijuar një mjedis mikpritës për personat lesbike, gej, biseksualë dhe transgjinnorë

Homofobia dhe transfobia në Shqipëri nuk janë të frymëzuara nga ligje që penalizojnë apo ndëshkojnë personat LGBT por janë më tepër pasojë e legjislacionit të vjetër, paragjyqimeve të trashëguara për orientimin seksual dhe identitetin gjinnor dhe mungesës së edukatës seksuale dhe transparencës shoqërore për këto tematika.

Për pasojë personat lesbike, gej, biseksualë, transgjinore, interseks që jetojnë në Shqipëri janë në mënyrë dërrmuese “të padukshëm” në sytë e institucioneve, familjarëve të tyre dhe shoqërisë në përgjithësi.

Ndërkohë, me rritjen e vizibilitetit të kauzës dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet kombëtare, organizatat si Ambasada PINK po zhvillojnë trajnime me institucione të tilla si Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Shërbimi Social Shtetëror, Policinë e Shtetit, Bashkitë, Mediat, etj. për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve LGBT.

Ndryshe nga perceptimet kolektive, personat LGBT vijnë nga kontekste të shumëllojshme kulturore, eksperiencash, stili jetese dhe mentaliteti. Por e përbashkëta është se personat LGBT ndihen të diskriminuar si nga individë ashtu edhe organizata të cilat për arsye të shumëllojshme duan të mohojnë ekzistencën e tyre.

Ne jetojmë ende në një shoqëri e cila mendon dhe pretendon se të gjithë janë heteroseksualë dhe se kanë një identitet gjinor që u është përcaktuar nga dita e lindjes. Për këtë arsye shumica e personave LGBT preferojnë të mos e rrëfejnë orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor dhe të ndihen të përjashtuar, të izoluar dhe jo të mirëpritur.

Materiali i mëposhtëm është një udhërrëfyes për të gjithë punonjësit e institucioneve publike dhe të gjitha ato institucione që duan të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve ndaj personave LGBT. Komuniteti LGBT nuk kërkon një trajtim “special” apo të veçantë nga qytetarët e tjerë. Ajo çka kërkohet është një trajtim gjithëpërfshirës, jo-diskriminues dhe krijimin e një mjedisi të sigurtë dhe të hapur për të gjithë.

GJUHA

1. Përpikuni të mësoni se si njerëzit përshkruajnë orientimin e tyre seksual, identitetin gjinor, partnerin/en, marrëdhëniet e tyre dhe përpikuni të bisedoni me mënyrën e tyre të komunikimit.
2. Shmangni prezumime për orientimin seksual apo identitetin gjinor të një individi: përdorni terma neutralë në aspektin gjinor të tilla si “partner”.
3. Në shumë gjuhë të botës personat LGBT adresohen me terma fyes dhe ofendues. Nëse përktheni materiale nga gjuhë të tjera përpikuni të kuptoni kontekstin kulturor të termave që po përdorni.
4. Kujdesi: Mjaft persona LGBT kanë përvetësuar terma të tilla si “pederast” “b*****ë” “homo” etj., duke folur për veten e tyre me ato terma. Por nuk është e përshtatshme që ju apo institucioni që ju përfaqësoni ti përdorë këto terma. Gjithashtu është e këshillueshme të evitoni përdorimin e termit “homoseksual” pasi ai perceptohet negativisht nga komuniteti dhe shoqëria. Termi homoseksual është shumë mjekësor dhe nuk ka të bëjë me kontekstin social dhe kulturor në të cilin ndëveprojnë qytetarët qofshin këta homoseksualë apo heteroseksualë.

POLITIKAT

5. Shfaqni në mjediset e institucionit një deklaratë. Ajo mund të jetë e tipit: “institucioni ynë ofron shërbime cilësore ndaj qytetarëve pavarësisht moshës, aftësisë së kufizuar, racës, besimit fetar apo orientimit seksual”. Ju mund ti informoni personat e stafit tuaj se çfarë do të thotë kjo gjë në praktikë.
6. Bëni të mundur që deklaratat dhe politikat e institucionit / organizatës tuaj janë të publikuara në mediat tuaja dhe janë të dukshme në të gjithë institucionin.
7. Tregoni “Tolerancë Zero” ndaj gjuhës fyese, raciste dhe homofobike.

9. Siguroni konfidencialitetin dhe privatësinë e të gjithë personave në stafin tuaj apo atyre që bashkëpunojnë me ju, përveç rasteve kur ata preferojnë të flasin hapur për veten e tyre. Konfidencialiteti mund të ketë të bëjë më sigurinë personale sesa thjesht me privatësinë.

10. Zbuloni mënyra kreative për të integruar çështjen LGBT në punën tuaj në vend që ta ndani atë apo ta vendosni si shtojcë të politikave tuaja.

11. Jini të kujdesshëm në fushat ku keni ndarje sipas gjinisë si praktikë pune dhe sigurohuni që të keni përfshirë nevojat e personave transgjinorë.

12. Personat LGBT vijnë nga të gjitha shtresat shoqërore. Principet e barazisë janë të rëndësishme edhe brenda komunitetit LGBT dhe ju duhet të siguroheni që të garantoni aksesin e përshtatshëm në shance dhe mundësi.

STAFI

13. Organizoni trajnime për stafin tuaj – të paguar ose jo, me kohë të plotë ose jo – mbi tematikën LGBT. Kjo jep një mesazh të qartë se diskriminimi i personave LGBT është i pa-pranueshëm dhe rrit dijet dhe botëkuptimin e personave mbi diskriminimin dhe problemet me të cilat përballen personat LGBT.

14. Inkurajoni stafin, punonjësit dhe vullnetarët tuaj që të shmangin komente apo “shaka” mbi personat LGBT apo për tematikën LGBT dhe sigurohuni që njerëzit të dinë përgjegjësitë e tyre. Kjo është me rëndësi për menaxherët të cilët kanë përgjegjësi për të garantuar barazi në vendin e punës dhe në bazë të ligjeve dhe rregullave të tjera të Kodit të Punës.

15. Inkurajoni punonjësit e stafit tuaj që të raportojnë incidente të abuzimit homofobik pavarësisht nëse ato ndodhin brenda apo jashtë mjedisit tuaj të punës. Merrini seriozisht të gjitha rastet e diskriminimit apo sjelljeve homofobike dhe transfobike në institucionin tuaj dhe trajtojini ato në mënyrën e duhur. Merrni informacion në lidhje me raportimin e rasteve të urrejtjes dhe për raportimin e incidenteve në Polici apo institucione të tjera.

16. Informacioni mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor të punonjësve duhet të jetë në mënyrë strikte konfidencial dhe duhet të trajtohet si i tillë nga departamentet e Burimeve Njerëzore.

17. Mbështesni raste pozitive, si për shembull persona LGBT të cilët kanë bërë “coming out” ose dalje hapur. Këto persona duhet të inkurajohen për tu përfshirë në çështje LGBT sidomos në kuadër të rritjes së mirëqenies së punonjësve në vendin e punës dhe nëse kanë dëshirë ata mund të punojnë brenda profilit të punës edhe mbi këtë temë. Vendosni postera apo materiale të tjera të cilat shfaqin imazhe apo komente pozitive për personat LGBT.

18. Nëse në stafin tuaj ka persona të cilët punojnë në mënyrë intensive me pjesën më të madhe të ekipit sigurohuni që ata janë të trajnuar siç duhet mbi çështje të barazisë dhe që ti trajtojnë të gjithë punonjësit me respekt dhe dinjitet pavarësisht identitetit të tyre.

19. Reklamoni thirrjet tuaja të punësimit apo shërbimet që ofroni pranë organizatave dhe grupeve LGBT si dhe në publikimet e tyre.

20. Mbani informacion për organizatat LGBT në qytetin apo vendin tuaj. Ju mund të ndihmoni personat LGBT në stafin apo mjedisin tuaj me të dhënat e tyre dhe mund të merrni pjesë në konferencat apo aktivitete të organizuara prej tyre.

PËRFSHIRJA

21. Kur publikoni apo reklamoni aktivitete apo konsultime me komunitetin LGBT mos harroni se personat LGBT nuk shkojnë vetëm në lokale gej apo organizata LGBT. Ju duhet ti publikoni këto informata në media dhe forume të përgjithshme gjithashtu.
22. Nëse po përdorni grupe të komunitetit LGBT për t'ju asistuar në konsultime apo punë të ndryshme përpikuni ti mbështesni ata qoftë financiarisht apo në mënyrë administrative për punën dhe mbështetjen e tyre.
23. Përpikuni të përdorni mjedis neutral për takimet tuaja apo një vend ku personat LGBT ndihen të qetë për të qenë të hapur, si për shembull një organizatë LGBT.
24. Kur punoni me persona LGBT, është e rëndësishme të mbani mend se ka shumë gjasa që ata të mos jenë të hapur në lagjen apo vendin ku jetojnë, për shkak të problemeve me të cilat mund të përballen. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme me punët që ju bëni në komunitet.
25. Ndërkohë që personat lesbike, gej, biseksualë dhe transgjinorë mund të kenë gjëra të përbashkëta, kini parasysh që shumë çështje janë specifike vetëm për grupe të veçanta.

Informacion dhe Vizibilitet

26. Shfaqja e informacioneve me tematikë LGBT në mjediset e institucionit tuaj krijon një atmosferë mikpritëse. Kjo mund të përfshijë postera të personave LGBT.
27. Imazhet e personave LGBT mund ti përdorni në të gjitha publikimet dhe reklamimet tuaja dhe jo thjesht në dokumenta që kanë të bëjnë me komunitetin LGBT. Kjo dërgon mesazhin e qartë se ju e njihni kontributin pozitiv që personat LGBT japin në shoqëri dhe se institucioni apo organizata juaj i mirëpret personat LGBT.
28. Sigurohuni që posterat dhe informacionet e tjera janë qartësisht të dukshme dhe se do të shihen për një kohë të gjatë nga stafi dhe publiku.
29. Mbështesni komunitetin LGBT duke reklamuar institucionin apo organizatën tuaj në publikime LGBT, duke sponsorizuar aktivitete LGBT ose duke punuar në partneritet me organizata LGBT.



4. **Axhenda e Trajnimit**

09:00 – 09:30	Regjistrimi i Pjesëmarrësve
09:30 – 10:00	Prezantimi i trajnuesve Icebreakers
10:00 – 11:00	Konceptet LGBTI
11:00 - 11:15	Pushim Kafe
11:15 – 12:30	Situata Ligjore e Komunitetit LGBTI
12:30 – 13:30	Pushimi i drekës
13:30 – 14:45	Situata Politiko-Sociale e Komunitetit LGBTI Ofrimi i shërbimeve miqësore për komunitetin LGBTI
14:45 – 15:00	Formular i Vlerësimit
15:00	Fund i Trajnimit

5. Formulari i Vlerësimit

1. Cili është mendimi juaj për mënyrën e zhvillimit të trainimit?

- a) më shumë kohë lektorit
- b) më shumë kohë diskutimeve
- c) tjetër

komente: _____

2. A mendoni se temat e trajnimit plotësuan nevojën tuaj për informacion?

Po _____ Jo _____ Mbase _____

3. Si i vlerësoni temat e mbuluara nga trajneri? (1 numri minimum, 5 numri maksimum)

1 _____ 2 _____ 3 _____ 4 _____ 5 _____

4. Cilat nga temat e referuara në këtë trajnim ishin më me interes për ju?

- Konceptet LGBTI _____
- Legjislacioni _____
- Problematikat e komunitetit _____
- Ofrimi i shërbimeve miqësore _____
- Të gjitha _____

5. Çfarë sugjerime keni për përmirësimin e mëtejshëm lidhur me temat e trajnimit?

6. A mendoni se informacioni i marrë në këtë trajnim do t'ju ndihmojë në përmirësimin e punës tuaj?

Po _____ Jo _____ Mbase _____

7. Nëse Po, cilat aspekte të trajnimit do t'ju ndihmojnë në punën tuaj?

Ju faleminderit për bashkëpunimin



REFERENCA

1. Shkalla "Kinsey" – The Kinsey Institute, Advancing Sexual Health and Knowledge Worldwide, Indiana University, Morrison 313, 1165 E, www.kinseyinstitute.org
2. Sam Killermann, 2015, Its Pronounced Metrosexual – The Genderbread Person, www.itspronounced-metrosexual.com
3. Ermal Mara, 2014, Homofobia dhe Heteroseksizmi, Respublica, <http://www.respublica.al/opinion/2014/05/04/homofobia-dhe-heteroseksizmi>
4. Etleva Bisha, 2011, "Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBT", Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri
5. 2010, "An Activist's Guide to The Yogyakarta Principles", https://iglhrc.org/sites/default/files/Activists_Guide_Yogyakarta_Principles.pdf & <http://www.yogyakartaprinciples.org/>
6. Këshilli i Europës, 2013, "Rekomandimi CM/Rek(2010)5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor", Strasbourg, & link: http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/Publications/LGBT_EN.pdf
7. 2014, "Nënshkrimi i Deklaratës së Angazhimit IDAHO 2014", <http://www.idaho2014forum.org/images/prs/IDAHO%20Declaration%20of%20Intent%20signing.pdf>, Valetta, Maltë.
8. LIGJ Nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", <http://kmd.al/skedaret/1308053956-Ligji%20per%20mbrojtjen%20nga%20diskriminimi.pdf>, & link: www.kmd.al
9. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2014 "Raport i veçantë, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri", Tiranë, & link: <http://kmd.al/skedaret/1419266310-RAPORT%20I%20VECANTE%20LGBT.pdf>
10. Richard Köhler, Alecs Recher, Julia Ehrt, 2013, "Legak Gender Recognition in Europe, Toolkit", link: http://www.tgeu.org/sites/default/files/Toolkit_web.pdf
11. Rinia Shqiptare, 2011: "Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen", Friedrich Ebert Stiftung & IDRA, 2011, link: http://www.fes-tirana.org/media/publications/pdf-files/2012/pub_Rinia%20shqiptare%202011.pdf
12. Blerina Metaj, 2011, 2012, 2013, 2014, "Raporte të shkeljes së të drejtave të personave LGBT", Tiranë, Shqipëri, Email: pinkembassy@crca.al
13. Prism & Bradford Equity Partnership, 2008, "How to be LGBT friendly", link: http://www2.warwick.ac.uk/services/equalops/resources/how_to_be_lgbt_friendly.pdf
14. Avokati i Popullit, 2012, "Rekomandim i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 për të drejtat e personave LGBT", Tiranë & link: http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raporti%20final%20per%20LGBT_03%20shtator%202012%20doc.pdf
15. Kristina Voko, 2013, "Aksesi në shërbime dhe cilësia e kujdesit shëndetësor për personat LGBT në Shqipëri – Raport Teknik", Avokati i Popullit, Tiranë

